



AUTORITETI I MBROJTJES FINANCIARE

2023
Raport Vjetor

© 2024

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa: Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10, Tiranë

Tel: +355 4 2251 355/6

Faks: +355 4 2250 686

E-mail: amf@amf.gov.al

URL: www.amf.gov.al



Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv	5
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	8
Bordi i Autoritetit	9
Përmbledhje Ekzekutive: Ngjarjet kryesore të vitit 2023	11
Roli i Autoritetit në Procesin e Integritimit Evropian	18

Kapitulli 1

ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE	20
1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	20
1.2 Tregu i Sigurimeve	24
1.3 Tregu i Fondeve të Pensionit Privat	26


Kapitulli 2

AKTIVITETI MBIKËQYRËS	27
2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	27
2.1.1 Pozicioni Financiar	27
2.1.2 Inspektimet	30
2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	34
2.2.1 Pozicioni Financiar	34
2.2.2 Inspektimet	45
2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve	46
2.2.4 Provigjonet Teknike	47
2.2.5 Risigurimet	51
2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit	55
2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Privat	57
2.3.1 Pozicioni Financiar	57

Kapitulli 3

AKTIVITETI RREGULLUES DHE LICENCUES	62
3.1 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit Privat	62
3.2 Rregullimi i Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	64
3.3 Rregullimi i Tregut të Tregut të Sigurimeve	67

3.4	Licencimi dhe Qeverisja	69
3.4.1.	Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	69
3.4.2	Tregjet e Kapitalit	72
3.4.3	Tregu i Sigurimeve	73
3.5	Masat Mbikëqyrëse dhe Administrative	76
Kapitulli 4		
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL		78
4.1	Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	78
4.2	Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar	79
4.2.1.	Memorandume Mirëkuptimi gjatë vitit 2023	79
4.2.2.	Bashkëpunime me Autoritete Homologe	80
4.2.3.	Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare dhe Rregullatore	81
4.3	Projekte	85
4.4	Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit	88
Kapitulli 5		
MBROJTJA KONSUMATORE DHE EDUKIMI FINANCIAR		90
5.1	Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit	90
5.2	Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë	92
5.3	Edukimi Financiar dhe Marrëdhëniet me Publikun	93
Kapitulli 6		
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL		96
6.1	Burime Njerëzore	96
6.2	Sistemet e Teknologjisë së Informacionit	98
6.3	Auditi i Brendshëm	101
STRATEGJI DHE OBJEKTIVA		103
SHTOJCA		
A.	Struktura Organizative e AMF-së	107
B.	Raport i Audituesit të Pavarur	108



Mimoza KAÇI

Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj Raportin Vjetor 2023, si dokumenti më i rëndësishëm institucional dhe ligjor, i cili ju njeh me veprimtarinë rregulluese dhe mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare përgjatë një harku kohor një vjeçar dhe prioritetet për vitet në vazhdim. Ky raport është produkt i përpjekjeve dhe punës sonë për sigurimin e stabilitetit, integritetit dhe transparencës në tregun e sigurimeve, atë të fondeve të investimit e të pensionit privat dhe tregjet e kapitalit.

Në fillim të vitit 2023 u miratua "Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027", e cila përcakton objektivat dhe prioritetet afatmesme të institucionit. Strategjia mbështet Autoritetin në përmbushjen e misionit të tij për sigurimin e funksionimit efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre, në mbrojtje të interesave të konsumatorit dhe investitorit.

Me përfundimin e procesit *screening*, viti 2023 u kthye në vitin e mundësisë për progres të mëtejshëm të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, në shkurt të vitit 2023, grupi negociues për Kapitullin 9 "Shërbimet financiare", nën drejtimin e Autoritetit, realizoi me sukses takimin bilateral që u mbajt në Bruksel, ku u prezantua me përkushtim dhe profesionalizëm progresi i bërë në përafrimin e legjislacionit vendas në fushën e shërbimeve financiare me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Ky proces gjeti reflektim edhe në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, sipas të cilit për Kapitullin 9, Shqipëria rezultoi më e avancuar krahasuar edhe me vendet që i kanë hapur më herët negociatat e anëtarësimit. Në kuadër të angazhimeve të ndërmarra në takimin bilateral, Autoriteti në cilësinë e udhëheqësit të Kapitullit 9, po vijon me një sërë nismash në mbështetje të procesit të harmonizimit të plotë të legjislacionit tonë për shërbimet financiare me ato të BE-së.

Tregjet nën mbikëqyrje ecën në një trajektore të stabilizuar zhvillimi dhe rritje, me tregues të mirë të shëndetit financiar. Në fund të vitit 2023, totali i aseteve të tregjeve nën mbikëqyrje shënoi vlerën prej rreth 108 miliardë lekë, me një rritje prej 12% krahasuar me një vit më parë.

Autoriteti ka treguar vëmendje të shtuar në krijimin e një mjedisi rregullator, që nxit zhvillimin, adreson rreziqet dhe mbron interesat e konsumatorëve dhe investitorëve. Gjatë 2023, Autoriteti u angazhua në një sërë nismash ligjore dhe rregullatore për të siguruar mirëfunksionimin, eficiencën dhe zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje. Ligji i ri për fondet e pensionit privat, miratuar në vitin 2023, përmirëson më tej bazën ligjore, nxit zhvillimin e këtij tregu dhe e për afron atë me direktivën e BE-së.

Në vitin 2023, u miratuan gjithashtu të gjitha aktet nënligjore që plotësuan kuadrin rregullator në zbatim të ligjit për tregjet e kapitalit, të cilat sollën efektet e para pozitive në treg me emetimin për herë të parë të obligacioneve korporative me ofertë publike.

Një tjetër hap drejt integritetit të tregut tonë financiar në tregun evropian është krijimi i mundësive që qytetarët shqiptarë të investojnë në fonde të licencuara në Bashkimin Evropian. Miratimi i kuadrit rregullator në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive ka krijuar alternativa të reja për investime në instrumente financiarë dhe portofole të diversifikuara në tregun e fondeve të investimit. Këto mundësi e vendosin Shqipërinë në një stad të avancuar, sa i përket shërbimeve financiare, edhe pa qenë anëtar me të drejta të plota në BE.

Autoriteti synon të modernizojë dhe të për afrojë më tej kuadrin ligjor të tregut të sigurimeve me *acquis* të BE-së, bazuar edhe në raportin e vlerësimit të përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të Autoritetit me Parimet Themelore në Sigurime (ICP), të miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në qershor 2023.

Veprimtaria e Autoritetit u pasurua edhe me nisma në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje. Miratimi nga Këshilli i Ministrave i Dokumentit të Politikave “Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri 2023- 2027” është një hap pozitiv në mbështetje të zhvillimit të këtij tregu. Autoriteti po bashkëpunon me institucione vendase dhe partnerë ndërkombëtarë për zbatimin e planeve të veprimit të përcaktuara në këtë dokument.

Me qëllim rritjen e njohurive financiare dhe ndërgjegjësimit të publikut për mundësitë e investimit dhe njohjen e produkteve financiare, Autoriteti miratoi në gusht 2023 dokumentin “Strategjia për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027”. Aktivitetet për edukim financiar synojnë rritjen e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së grupeve të interesuara të popullatës në tregjet financiare.



Autoriteti thelloi më tej bashkëpunimin ndërkombëtar, përmes nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me rregullatorë të vendeve të BE-së, me Luksemburgun dhe Austrinë, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përfitim të praktikave më të mira mbikëqyrëse.

Në vijim të bashkëpunimit të mirë në nivel ndërkombëtar dhe vlerësimeve pozitive të marra nga organizatat ndërkombëtare, Autoriteti do të jetë mikpritësi i Konferencës Vjetore të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në vitin 2025. Ky event, që zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, është aktiviteti më i rëndësishëm vjetor i sektorit të sigurimeve në nivel botëror. Ky është tregues i qartë për kapacitetet institucionale të Autoritetit, besueshmërinë dhe marrëdhëniet e shkëlqyera me IAIS dhe institucionet homologe.

Prioriteti ynë për vitet në vazhdim mbetet forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes, përafrimi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe integrimi evropian, në funksion të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve, me qëllim përmbushjen e objektivit themelor të institucionit, atë të mbrojtjes së interesave të konsumatorit dhe investitorit.

Uroj që ky Raport të jetë me interes për Ju!

Mimoza KAÇI

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Mimoza Kaci

Misioni dhe funksionet e Autoritetit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Autoriteti) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve, tregut të letrave me vlerë, tregut të fondeve të pensioneve private dhe operatorëve të tyre, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Përbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi parësor i Autoritetit është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Në ushtrimin e veprimtarisë rregullative dhe mbikëqyrëse, Autoriteti udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.





Në vitin 2023, Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar:	Z. Olsi Çoku,	Kryetar Bordi, Anëtar Joekzekutiv
Anëtarë:	Z. Ervin Mete,	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv*
	Znj. Mimoza Kaçi,	Nëndrejtor Ekzekutiv**
	Z. Ildir Gjata,	Anëtar Joekzekutiv
	Z. Deniz Deralla,	Anëtar Joekzekutiv

Funksionet dhe kompetencat e Bordit të Autoritetit janë parashikuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar. Në zbatim të tij, Bordi miraton politikat e strategjitë e zhvillimit të Autoritetit dhe të tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe aktet nënligjore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtyre tregjeve, institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare jobankare që mbikëqyren nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2023, Bordi ka zhvilluar 13 mbledhje dhe ka marrë 221 vendime. Vendimet që lidhen me tregun e sigurimeve zënë numrin më të madh të vendimeve të miratuara. Në vëmendje të Bordit kanë qenë edhe zhvillimet e tregjeve të tjera, si ai i sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe tregut të titujve, për të cilat janë marrë vendime të rëndësishme.

Duke e cilësuar plotësimin e kuadrit rregullator për tregjet nën mbikëqyrje si një ndër prioritetet e punës së tij, Bordi i Autoritetit ka miratuar 15 rregullore të reja, një manual dhe tre udhëzime, si dhe ka ndryshuar një udhëzim ekzistues. Gjithashtu janë miratuar dy dokumente të rëndësishme, “Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027” dhe “Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për Edukim e Përfshirje Financiare 2023-2027”. Gjatë 2023 Bordi miratoi tre memorandume mirëkuptimi me autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe një marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional.

* Z. Ervin Mete, ka qenë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv deri më datë 11.09.2023, kur është liruar nga ky funksion nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për t’u emëruar Ministër i Financave dhe Ekonomisë.

** Znj. Mimoza Kaçi që prej muajit shtator 2023, drejton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar. Kuvendi i Shqipërisë me vendim Nr. 38/2024, datë 11.4.2024 emëroi Znj. KAÇI në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit.

Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së gjatë vitit 2023 sipas llojit të vendimit

<i>Llojet e vendimeve</i>	<i>Numër</i>
Vendime për shoqëritë dhe subjekte të tjera që veprojnë në tregun e sigurimeve	105
Vendime për bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e titujve	30
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private dhe SIK	34
Vendime për bashkëpunimin institucional	4
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	28
Vendime për kuadrin rregullues të Autoritetit dhe tregjeve të mbikëqyrura	20
<i>Vendime në tërësi</i>	221



Autoriteti miratoi gjatë vitit 2023 dy dokumente strategjike, "Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027" dhe "Strategjia për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027". Strategjia e Autoritetit reflekton misionin dhe vizionin e institucionit, duke përcaktuar prioritetet strategjike, lidhur me forcimin e stabilitetit financiar, rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve, përafrimin e legjislacionit me standardet evropiane, mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe investitorit, të ndërlidhura këto edhe me zhvillimin e financimit të gjelbër, si dhe me digjitalizimin e përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit 2023 ka reflektuar prioritetet dhe objektivat strategjike për të kontribuar në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Autoriteti, gjatë vitit 2023, ka vijuar me ushtrimin e një mbikëqyrjeje të kujdesshme, monitorimin e treguesve kryesorë financiarë, si dhe sigurimin e transparencës dhe integritetit të tregjeve financiare jo bankare nën mbikëqyrje, duke kontribuar në ruajtjen dhe nxitjen e stabilitetit, si dhe mbështetjen e zhvillimit të tyre.

Në vitin 2023, totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit shënoi vlerën prej rreth 108 miliardë lekë, me një rritje prej 12% krahasuar me një vit më parë. Ky është një zhvillim pozitiv që vjen pas një tkurrjeje që pësuan asetet e tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit 2022, si pasojë e ngjarjeve në tregjet ndërkombëtare, shoqëruar me situata inflacioniste dhe rritje të normave të interesit. Nga pikëpamja e aseteve, tregu i sigurimeve dhe ai i fondeve të investimeve zënë respektivisht 46.9% dhe 46.8% të totalit të tregjeve nën mbikëqyrje.

Tregjet financiare nën mbikëqyrje, në fund të vitit 2023, paraqiten të mirëkapitalizuara dhe me tregues të mirë të shëndetit financiar.

Në tregun e sigurimeve u shënua një përmirësim i mëtejshëm i treguesve financiarë kryesorë që monitorohen nga Autoriteti. Aktivitetet e tregut të sigurimeve u rritën me rreth 7 miliardë lekë, me një rritje prej 16% krahasuar me vitin 2022. Rritje u shënua edhe sa i përket nivelit të provigjoneve teknike me rreth 1.49 miliardë lekë, ose 6.3% më shumë krahasuar me vitin 2022, si dhe u përmirësua më tej treguesi kyç i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme.

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve për vitin 2023 shënuan rritje prej 8.85% krahasuar me vitin 2022, duke arritur në rreth 23 miliardë lekë të ardhura. Rritje shënuan edhe dëmet e paguara bruto, me 1.89%, krahasuar me vitin 2022, duke arritur në 6.9 miliardë lekë.

Monitorimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BShS) ka qenë në fokus të Autoritetit, për t'i dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite. Adresimi i tyre ishte një nga objektivat kryesore të Ligjit të ri 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i cili ka pasur ndikim të konsiderueshëm në përmirësimin e aspekteve të funksionimit të Byrosë, procedurave të trajtimit dhe pagesës së dëmeve Fond Kompensimi, si edhe aspekte të tjera që kanë ndikuar në uljen e mëtejshme të stokut të dëmeve pezull. Gjatë vitit 2023, rezulton se 75% e aksidenteve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara, ose të paidentifikuara, janë trajtuar dhe paguar me procedura të përsheptuara, drejtpërdrejt nga shoqëritë e sigurimit. Dëmet e paguara Fond Kompensimi në vitin 2023 rezultojnë me një tejkalim prej 11.22 % kundrejt fondit të miratuar për vitin 2023, ose rreth 28 milionë lekë më shumë.

Ndryshimet ligjore të vitit 2021 mundësuan gjithashtu uljen e komisioneve të ndërmjetësimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Autoriteti miratoi rregulloren që kufizon komisionet në një nivel maksimal prej jo më shumë se 18% nga janari 2023. Kështu, komisionet e ndërmjetësimit në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm kanë vijuar të ulen dhe rezultojnë mesatarisht 16.4% për vitin 2023, ose 1.2% më të ulëta krahasuar me vitin 2022. Reduktimi i nivelit të komisioneve të ndërmjetësimit dhe shpenzimeve të marrjes në sigurim ka sjellë rritje të likuiditetit të shoqërive të sigurimit, për të realizuar në kohë pagesat e dëmeve.

Raporti Evropian i Aksidenteve rezulton të jetë përdorur në rreth 37.6% të rasteve për dëmet e trajtuara gjatë vitit 2023. Kjo praktikë, një risi në ligjin e ri, mundësoi zgjidhjen me marrëveshje mes drejtuesve të mjeteve të përfshira në aksident, në rastet e dëmeve me vlerë deri në 30.000 lekë, duke sjellë njëkohësisht edhe reduktim të dokumenteve për praktikën e dëmeve.

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK), i cili përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri, ka treguar qëndrueshmëri gjatë vitit 2023 dhe ka shfaqur tendencë në rritje, krahasuar me një vit më parë. Rol në këtë drejtim kanë luajtur masat e marra nga shoqëritë administruese, bazuar edhe në vendimet e Autoritetit për të përballuar efektet e luhatjeve të tregjeve financiare, si dhe të treguesve makroekonomikë gjatë vitit 2022, masa të cilat e shtrinë efektin e tyre pozitiv edhe gjatë vitit 2023. Qëndrueshmëria dhe tendenca në rritje e këtij tregu u konstatua si në nivel aktivesh në tregun e fondeve të investimeve, ashtu edhe në nivelin e flukseve neto pozitive, kthimit nga investimi për investitorët dhe numrin e investitorëve.

Si rezultat i tendencës pozitive të këtyre treguesve dhe stabilizimit të tregut të SIK, masat e marra nga Bordi i Autoritetit lidhur me rritjen e frekuencës së raportimit



për çdo fond sa i përket shlyerjeve neto, treguesit të likuiditetit dhe rezultatet e *stress testeve*, u aplikuan deri në qershor të vitit 2023.

Totali i aktiveve neto të tregut të SIK për periudhën 31.12.2023 arriti në rreth 50.28 miliardë lekë, me një rritje 9.19% krahasuar me vitin 2022, ndikuar kjo kryesisht nga rritja në aktivet neto të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Numri i investitorëve në 31.12.2023 në tregun e fondeve të investimit arriti në 32,185, me një rritje prej rreth 11.16% krahasuar me një vit më parë.

Në tregun e SIK, gjatë vitit 2023, ka pasur zhvillime pozitive shoqëruar me kërkesa në rritje për njohjen dhe licencimin e formave të reja të SIK. Gjatë këtij viti, u licencua një fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, administruar nga një shoqëri administruese, e cila ushtron edhe veprimtarinë e administrimit të aktiveve të fondeve të pensionit privat.

Në vitin 2023, iu dha e drejta 2 fondeve të investimit të licencuara në BE të jenë të pranishëm në Shqipëri, duke ofruar risi për tregun shqiptar për shkak të karakteristikave ESG (mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative) që mbartin këto fonde.

Tregu i fondeve të pensionit privat ka vijuar tendencën e tij në rritje, sa i përket vlerës së aktiveve neto dhe numrit të anëtarëve. Në krahasim me vitin 2022, vlera neto e aktiveve të këtij tregu më 31.12.2023 arriti në 6.7 miliardë lekë, me një rritje prej 18.22%, ndërsa numri i anëtarëve arriti në 38,180, duke shënuar një rritje me 4.55% krahasuar me fundin e vitit 2022.

Gjatë vitit 2023, në tregun e fondeve të pensionit privat ushtruan aktivitetin e tyre gjathtë fonde pensioni të administruara nga katër shoqëri administruese, të cilat përveç administrimit të fondeve të pensionit janë licencuar për të administruar edhe sipërmarrje të investimeve kolektive.

Investimet e tregut të fondeve të pensionit privat në 31.12.2023 arritën në 6.48 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me 17.97% krahasuar me vitin 2022. Investimet u përqendruan kryesisht në obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, duke zënë një peshë prej 95.95% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit.

Në tregjet e kapitalit, gjatë vitit 2023, me miratimin e kuadrit të plotë rregullativ në harmonizim me direktivat evropiane të fushës, u krijua infrastruktura e përshtatshme rregulatore për rritjen e transparencës dhe integritetit. Emetimi për herë të parë i titujve nëpërmjet ofertës publike është një sinjal pozitiv për zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe për alternativat e reja të investimit që i ofrohen investitorit.

Edhe gjatë vitit 2023, tregjet e kapitalit vijuan të jetë të përqendruar në tregun e titujve të Qeverisë dhe atë të obligacioneve me ofertë private. Shuma e obligacioneve me ofertë private në treg, në fund të vitit 2023 arriti në rreth 20 miliardë lekë nga rreth 14 miliardë lekë në fund të vitit 2022.

Krahas miratimit të strategjisë institucionale, në drejtim të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe rritjes së përfshirjes në produktet financiare, Autoriteti në muajin gusht 2023 miratoi edhe “Strategjinë për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027”, e cila përfshin ndërmarrjen e hapave të bashkërenduar për rritjen e edukimit financiar në funksion të rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit të publikut lidhur me mundësitë që ofrojnë këto tregje.

Viti 2023 ka qenë një vit me zhvillime të rëndësishme dhe arritje për Autoritetin në drejtim të:

- Avancimit në procesin e integritit në Bashkimin Evropian;
- Përafrimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator të tregjeve nën mbikëqyrje me direktivat dhe rregulloret e BE-së përmes hartimit dhe miratimit të një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore;
- Nismave në funksion të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje; si dhe
- Forcimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës përmes forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në kuadër të procesit *screening*, i cili përfundoi me sukses për Shqipërinë në vitin 2023, Autoriteti kryesoi Kapitullin 9 “Për Shërbimet financiare”, ku grupi negociues prezantoi progresin e arritur në përafrimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve financiare me *acquis* të BE-së. Ekspertët e Komisionit Evropian vlerësuan pozitivisht progresin e bërë dhe angazhimet e marra në Kapitullin 9 dhe vijimin e përafrimit ligjor në fushën e shërbimeve financiare.

Progresi i arritur në Kapitullin 9 e vendos Shqipërinë përpara gjithë vendeve të tjera të rajonit në fushën e shërbimeve financiare, referuar edhe gjetjeve të Progres Raportit 2023 të Komisionit Evropian. Me avancimin nga niveli “mesatarisht i përgatitur” në “mesatarisht i përgatitur/nivel i mirë i përgatitjeve”, Kapitulli 9 është i vetmi ku Shqipëria rezulton më e avancuar krahasuar edhe me vendet që i kanë hapur më herët negociatat e anëtarësimit.

Në kuadër të përafrimit ligjor dhe rregullator me *acquis* të BE-së dhe në zbatim të angazhimeve të Planit Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE), gjatë muajit nëntor 2023, Autoriteti u asistua nga një mision i programit të Komisionit Evropian për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim Informacioni (TAIEX), me ekspertë nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë (HANFA), mbi zbatimin e direktivës së regjimit mbikëqyrës Solvency II. Rekomandimet e lëna nga ekspertët e TAIEX-it në raportin e tyre përfundimtar, do të mbahen në konsideratë gjatë përgatitjes së ndryshimeve në ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.



Me miratimin e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, i cili hyri në fuqi në 6.11.2023, Autoriteti kontribuoi në përmirësimin dhe modernizimin e mëtejshëm të bazës ligjore të këtij tregu dhe nxitjen e zhvillimit të tij, duke realizuar gjithashtu një përafrim të mëtejshëm me Direktivën 2016/2341/KE “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional” (IORP II). Ky ligj, përmes formave të reja të pensioneve private, përmirësimin të aspekteve menaxheriale, rritjes së transparencës, uljes së komisioneve të administrimit dhe ofrimit të një sërë incentivave fiskale, synon të kontribuojë në zgjerimin e tregut të fondeve të pensionit privat. Autoriteti ka filluar procesin e hartimit e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Pas miratimit të Ligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Autoriteti ka miratuar dy rregullore të rëndësishme të cilat për herë të parë mundësojnë marketimin dhe shitjen edhe në Shqipëri të fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuara në një vend anëtar të BE-së, përmes procesit të njohjes së këtyre fondeve dhe regjistrimit të agjentit që i përfaqëson. Kjo i jep mundësi investitorëve shqiptarë të investojnë në fonde të licencuara në një vend të BE-së, duke e vendosur gjithashtu Shqipërinë në një stad të avancuar sa i përket shërbimeve financiare edhe pa qenë ende anëtar me të drejta të plota në BE.

Në qershor 2023, Komiteti Ekzekutiv i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) miratoi raportin përfundimtar të vlerësimit të përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të Autoritetit me Parimet Themelore në Sigurime (ICP). Nga vlerësimi rezultoi një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie. Ky vlerësim përbën një përparim domethënës kundrejt rezultateve të vlerësimit të kryer 10 vite më parë nga Banka Botërore dhe FMN. Autoriteti ka konsideruar rekomandimet e lëna nga ky proces vlerësimi dhe i ka integruar ato në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve, me synim përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime dhe me Direktivat Evropiane të fushës.

Në nëntor 2023 u organizua takimi i parë i përbashkët me Bankën Botërore, e cila si një nga partnerët kryesorë, do të vijojë të mbështesë Autoritetin në projektin e radhës të asistencës “Qëndrueshmëria dhe Zhvillimi Financiar; Rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe aksesit në financa të gjelbra dhe novatore”. Ky projekt financohet nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO). Në këtë projekt, Autoriteti do të përfitojë asistencë në sektorin e sigurimeve përmes zbatimit të udhërrëfyesit drejt Solvency II dhe implementimit të standardeve të raportimit financiar IFRS 17, në tregun e fondeve të pensioneve private, përmes hartimit të akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të ligjit të ri, në tregjet e kapitalit, me fokus obligacionet e

gjelbra, si edhe në fushën e teknologjisë së informacionit përmes përmirësimit të sistemeve të brendshme të IT, platformave të raportimit, zhvillimet FinTech, si dhe sigurinë kibernetike.


Autoriteti miratoi në gusht 2023 Udhëzimin mbi “Raportimin e shoqërive të sigurimit për zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e sigurimit”. Udhëzimi parashikon hapa konkretë dhe afate për raportime të ndërmjetme të shoqërive të sigurimit, deri në zbatimin e plotë të tij.

Gjatë vitit 2023, Autoriteti përfundoi plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “ Për Tregjet e Kapitalit”, me synim përafrimin e mëtejshëm me direktivat dhe rregulloret e BE-së, rritjen e transparencës dhe besimit të investitorit në mekanizmat e tregut, si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së emetuesve dhe investitorëve në këtë treg. Autoriteti përfundoi gjithashtu miratimin e kuadrit rregullator në zbatim të ligjit për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, të përafruara me direktivat evropiane të fushës.

Viti 2023 u karakterizua nga një sërë nismash të ndërmarra nga Autoriteti në bashkëpunim me institucione me rol kyç, në funksion të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Autoriteti në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave finalizoi Dokumentin e Politikave “Për krijimin e një mjedisi mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, i miratuar në prill 2023 nga Këshilli i Ministrave. Me miratimin e këtij dokumenti janë përcaktuar planet konkrete të veprimit për zhvillimin e tregjeve të kapitaleve përgjatë një periudhe 5-vjeçare. Në kuadër të zbatimit të këtij dokumenti, Autoriteti po bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në drejtim të nxitjes dhe zhvillimit të tregut të kapitaleve.

Në tetor të vitit 2023 Autoriteti në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Bankën Botërore organizoi konferencën Ndërkombëtare “Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve-Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”, me përfaqësues të nivelit të lartë të Qeverisë Shqiptare, institucioneve financiare ndërkombëtare, autoriteteve mbikëqyrëse financiare të rajonit dhe BE-së dhe pjesëmarrësve të tregut vendas dhe ndërkombëtar. Kjo Konferencë shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të sigurimeve në Shqipëri, adresimit të sfidave të përbashkëta rajonale, rolit të sigurimeve në menaxhimin e riskut të katastrofave, si dhe sfidat për zhvillimin e sigurimeve në bujqësi.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Autoriteti ka thelluar komunikimin dhe bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, rregullatorët e vendeve të rajonit dhe të BE-së, me qëllim shkëmbimin e informacionit, të



eksperiencave më të mira, si dhe përfitimin e asistencës teknike në drejtim të rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje.

Autoriteti nënshkroi dy Memorandume Mirëkuptimi me autoritetet rregullatore evropiane, atë me Komisionin Mbikëqyrës të Sektorit Financiar të Luksemburgut (CSSF) dhe me Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare (FMA). Këto memorandume synojnë forcimin e bashkëpunimit midis rregullatorëve, në mënyrë të veçantë për çështje lidhur me rregullimin dhe mbikëqyrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Memorandumi me FMA mundëson kryerjen e aktivitetit të llojeve të reja në tregjet shqiptare dhe gjithashtu tregtimin dhe shitjen ndërkufitare të kuotave të tyre.

Në vijim të vlerësimeve pozitive dhe bashkëpunimit të mirë në nivel ndërkombëtar, në vitin 2025 Shqipëria do të jetë vendi pritës i Konferencës Vjetore të IAIS, aktiviteti më i rëndësishëm vjetor i sektorit të sigurimeve në nivel global. Kjo është hera e parë që aktiviteti më i madh vjetor i sektorit të sigurimeve zhvillohet në Shqipëri, por dhe në rajon. Ky është tregues domethënës për kapacitetet institucionale, besueshmërinë dhe marrëdhëniet e shkëlqyera të Autoritetit me IAIS dhe institucionet homologe.

Në vijimësi, Autoriteti do ndjekë zbatimin e prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë institucionale dhe dokumente të tjera strategjike, si dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

ROLI I AUTORITETIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Viti 2023 shënoi zhvillime të rëndësishme pasi Shqipëria përmbylli me sukses takimet dypalëshe për të gjithë kapitujt. Në këto takime, pala shqiptare paraqiti situatën aktuale në terma ligjorë, institucionalë dhe të implementimit të kuadrit legjislativ, duke evidentuar hendeqet ekzistuese ligjore dhe institucionale ose administrative në krahasim me *acquis* e BE-së. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e këtyre takimeve u dedikohet edhe planeve për përafrim të mëtejshëm me *acquis* e BE-së, duke parashtruar kështu vullnetin dhe qartësinë në përmbushjen e kriterëve kryesore në çdo kapitull për ecjen përpara të negociatave të anëtarësimit. Komisioni Evropian pritet të miratojë në Këshillin e BE-së Raportin *Screening* për grupkapitullin e dytë, pjesë e të cilit është edhe Kapitulli 9 “Shërbimet Financiare”.


Në kuadër të negociatave, Autoriteti drejton Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, si edhe kontribuon në një sërë kapitujsh, si pjesë e grupeve ndërinstitucionale. Në takimin bilateral për këtë Kapitull 9 që u zhvillua në 13-14 shkurt 2023 në Bruksel, përfaqësues të Autoritetit, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, prezantuan në mënyrë të detajuar nivelin e përafrimit me direktivat evropiane të fushës.

Autoriteti ka vijuar të japë kontributin e tij në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, atë të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës, të Çështjeve Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, si dhe për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian.

Autoriteti ka ndjekur në vijimësi zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) për periudhën 2023-2025, hartimin dhe miratimin e akteve të parashikuara në PKIE nga institucionet kontribuese të kapitullit. Autoriteti dhe institucionet e tjera kontribuese të Kapitullit 9 hartuan Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030 dhe Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2024-2026.

Autoriteti ka pasur rol drejtues në koordinimin e punës me institucionet kontribuese në këtë kapitull, nëpërmjet mbledhjeve të shpeshta të grupeve ndërinstitucionale të punës së integritimit evropian dhe nëpërmjet bashkëpunimit me Zyrën e Kryenegociatorit.

Në kuadër të angazhimeve në takimin bilateral Autoriteti ka ngritur grupin e përbashkët të punës me ekspertë të Autoritetit dhe BSH-së dhe ka filluar hartimi i udhërrëfyesit për transpozimin e direktivës 2002/87/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 16 dhjetor 2002, mbi mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, ndërmarrjeve të sigurimit dhe firmave të investimeve në një konglomerat financiar.



Autoriteti ka vazhduar bashkëpunimin me anëtarët e platformës së partneritetit për integrimin Evropian (PPIE), nëpërmjet organizimit të tryezave së diskutimit dhe këshillimit. Platforma e partneritetit për integrimin Evropian (PPIE) është mbështetur edhe nga projekti “Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit për Kapitujt Ekonomikë të Acquis”- SANECA II, financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe zbatohet nga GIZ në Shqipëri.

Në nëntor 2023, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit 2023 për Shqipërinë, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria në Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, ku përfshihen sektori bankar, ai i sigurimeve, pensioneve private, si edhe shërbimet e investimeve dhe tregjet e kapitalit. Raporti vlerëson se Shqipëria ndodhet mes një niveli të moderuar dhe të mirë përgatitjeje në fushën e shërbimeve financiare. Progres u shënua edhe në përafrimin e legjislacionit kombëtar të tregut të kapitalit me *acquis* përkatëse të BE-së dhe në përfshirjen e parimeve të qëndrueshme financiare në politikat dhe objektivat strategjike bankare dhe jobankare.

Kapitulli 1

Ecuria e Tregjeve nën Mbikëqyrje

Gjatë vitit 2023, totali i asetëve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit arriti në vlerën rreth 108 miliardë lekë, me një rritje prej 12% krahasuar me një vit më parë. Nga pikëpamja e asetëve, tregu i fondeve të investimeve dhe i sigurimeve zënë peshën kryesore të totalit të asetëve të tregjeve nën mbikëqyrje.

1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK), i cili përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri, gjatë vitit 2023, ka treguar qëndrueshmëri dhe ka shfaqur tendencë në rritje, krahasuar me një vit më parë. Qëndrueshmëria dhe tendenca në rritje e këtij tregu u konstatuan si në nivel aktivesh të tregut të fondeve të investimeve, ashtu edhe në nivelin e flukseve neto pozitive, kthimit nga investimi për investorët dhe numrin e investorëve. Masat e marra nga shoqëritë administruese, mbështetur edhe nga vendimet e marra nga Autoriteti për të përballuar efektet e luhatjeve të tregjeve financiare, si dhe të treguesve makroekonomikë gjatë vitit 2022, e shtrinë efektin e tyre edhe gjatë vitit 2023, duke rezultuar pozitive në drejtim të qëndrueshmërisë dhe rritjes së këtij tregu.

Totali i aktiveve neto të tregut të SIK për periudhën 31.12.2023 arriti në rreth 50.28 miliardë lekë, me një rritje 9.19% krahasuar me vitin 2022, ndikuar kryesisht nga rritja në aktivet neto të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Për të njëjtën periudhë, totali i aktiveve neto të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është në vlerën rreth 45.45 miliardë lekë me një rritje prej 9.62%, krahasuar me fundvitin 2022. Totali i aktiveve neto të fondeve të investimeve alternative në 31.12.2023 është në vlerën 4.83 miliardë lekë me një rritje prej 5.31% krahasuar me fundvitin 2022.

Numri i investorëve për 31.12.2023 në tregun e fondeve të investimit është 32,185, ku përfshihen edhe 4 investorë të fondeve të investimeve alternative. Numri i investorëve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 32,181 duke shënuar një rritje prej 11.16% gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2023, aktivet e SIK, u administruan nga pesë shoqëri administruese, tre prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit, për SIK edhe për fondet e pensionit privat.

Në tregun e SIK, gjatë vitit 2023 ka pasur zhvillime pozitive shoqëruar me kërkesa në rritje për njohjen dhe licencimin e formave të reja të SIK.



Gjatë këtij viti, është licencuar nga Autoriteti për të kryer aktivitet në këtë treg, një fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, administruar nga një shoqëri administruese, e cila ushtronte veprimtarinë e administrimit të aktiveve të fondeve të pensionit privat.

Tregu i fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë 78.62% të aktiveve të këtij tregu, kundrejt 75.93% që ka qenë në fund të vitit 2022.

Në kuadër të respektimit të kërkesave rregullatore për likuiditetin, shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, të cilat investojnë në tregje jo aktive, të mbajnë likuiditet në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ në fuqi. Deri në fund të qershorit të vitit 2023, Autoriteti mbajti në fuqi masat e marra përmes vendimeve të Bordit lidhur me rritjen e frekuencës së raportimit për çdo fond në lidhje me shlyerjet neto, treguesin e likuiditetit dhe rezultatet e stress testeve. Këto masa nuk vijuan të aplikohen gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, si rezultat i tendencës pozitive të treguesve të sipërpërmendur dhe stabilizimit të tregut të SIK.

Tregjet e kapitalit

Gjatë vitit 2023, Autoriteti luajti një rol proaktiv në nxitjen e zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vend, duke synuar në rritjen e transparencës dhe integritetit të tregjeve nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit, në përputhje me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Me miratimin e tyre gjatë vitit 2023, kuadri rregullator për rregullimin dhe mirëfunksionimin e tregjeve të kapitalit konsiderohet i përfunduar. Kërkesat e reja rregullatore synojnë rritjen e besimit të investitorit në mekanizmat e tregut, si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së emetuesve dhe investitorëve.

Me miratimin e Rregullores nr. 4, datë 26.01.2023 “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe/ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar” u krijua kuadri i përshtatshëm rregullator për emetimin e titujve me ofertë publike. Në prill 2023, Bordi i Autoritetit, me Vendimin nr. 72, datë 28.04.2023, miratoi për herë të parë prospektin e një institucioni financiar jo bankë për emetimin e obligacioneve me ofertë publike. Emetimi për herë të parë i titujve nga një shoqëri nëpërmjet ofertës publike është një sinjal pozitiv për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe për alternativat e reja të investimit që i ofrohen investitorit shqiptar për të diversifikuar portofolin e tij, në përputhje me karakteristikat dhe profilin e rrezikut të investitorit.

Ky emetim me ofertë publike aktivizoi të gjithë mekanizmat e tregut të kapitaleve, që mbështetin procesin e emetimit dhe tregtimit të titujve, siç janë ndërmjetësit financiarë, Bursa dhe Depozitari Qendror i Titujve. Infrastruktura e tregtimit dhe ajo e pas tregtimit rezultoi të jetë funksionale. Gjithashtu ky emetim i shton tregut shqiptar të kapitaleve një instrument të ri financiar, duke zgjeruar gamën e tyre.

Në mbështetje të zhvillimit të tregjeve të kapitalit, Autoriteti, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave finalizoi në vitin 2023 hartimin e dokumentit politik “Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”. Ky dokument u miratua nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 266, datë 26.04.2023 dhe ka si objekt kryesor zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, si një alternativë e qëndrueshme financimi përkundrajt burimeve tradicionale të financimit. Ky dokument përmban plane konkrete veprimi për zhvillimin e tregjeve të kapitaleve përgjatë një periudhe 5-vjeçare. Në këtë kuadër, Autoriteti ka filluar punën për zbatimin e planeve të veprimit, duke bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, institucionet ndërkombëtare, si dhe përmes asistencës teknike.

Në tregjet e kapitalit, gjatë vitit 2023, ushtruan veprimtarinë e tyre subjektet e mëposhtme:

- 11 subjekte, nga të cilat 9 banka për ofrimin e shërbimeve të investimit dhe shërbimit ndihmës të kujdestarisë, 2 shoqëri komisionere, nga të cilat një me status pezull;
- 1 Bursë titujsh;
- 1 Regjistrar Titujsh dhe Depozitar Qendror Titujsh, i cili krahas shërbimit të regjistrimit kryen edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes së titujve.

Tabelë 2: Pjesëmarrës dhe subjekte të tregut të kapitaleve, dhjetor 2023

(Në numër)

Shoqëri Komisionere/Banka	Banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë të titujve	Banka që ofrojnë shërbimin e administrimit të portofolit
11	9	1
Banka që ofrojnë shërbimin e këshillimit dhe dhënies së rekomandimeve për investime	Banka që ofrojnë shërbimin e nënshkrimit të instrumentave financiare	Banka që ofrojnë shërbimin e investimit <i>online</i>
1	2	2
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Private	Bursë Titujsh (Tregu i Rregulluar)	Depozitar Qendror Titujsh
Emetues me Ofertë Private 1 Emetues me Ofertë Publike 1	1	1



Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë


Tregjet e kapitalit dominohen nga tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i obligacioneve, ku pjesën më të madhe e zë tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private.

Tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare mbetet segmenti më i madh dhe aktiv që mbizotëron në tregjet e kapitalit. Titujt e qeverisë tregtohen në Bursën Shqiptare të Titujve dhe në tregun me Pakicë, i organizuar në formën e tregut mbi banak (OTC). Vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve të realizuara në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë në vitin 2023 arriti në rreth 94.2 miliardë lekë. Sipas të dhënave statistikore të Autoritetit për periudhën janar-dhjetor 2023, në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë, dominojnë: transaksioni “Blerje në tregun primar”, i cili përbën rreth 42.58% të vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve, dhe transaksioni “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, i cili përben rreth 47.35% të vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Përsa i përket aktivitetit në tregun sekondar ai përmban rreth 8.4% të totalit të transaksioneve të kryera në këtë treg.

Gjatë vitit 2023, vëllimi i blerjeve në tregun primar nga klientët me pakicë, nëpërmjet subjekteve banka të licencuara arriti në 40.1 miliardë lekë, me një rënie prej 23.6% në krahasim me vitin 2022. Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2023 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.31% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Grafik 1: Transaksione në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë, 2023


(Në %)



Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2023, u dominua në masën 67.59% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 32.41% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione).

Grafik 2: Vëllimi i tregimit në tregun sekondar sipas llojit të titujve, 2023

(Në %)



1.2 Tregu i Sigurimeve

Në tregun e sigurimeve edhe gjatë vitit 2023 operuan 12 shoqëri sigurimi. Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në rreth 22.9 miliardë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 8.85% krahasuar me vitin 2022. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto u rritën si në aktivitetin e Jetës, ashtu dhe në atë të Jo-Jetës.


Në aktivitetin e Jetës, në vitin 2023, primet e shkruara bruto u rritën me 10.24% krahasuar me një vit më parë. Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të Jetës së debitorit, të cilat përbëjnë rreth 118.53% të totalit të rritjes së primeve në sigurimin e Jetës.

Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto, në vitin 2023 u rritën me 8.73% krahasuar me vitin 2022. Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik, me rreth 53.64% e totalit të rritjes së primeve në sigurimin e Jo-Jetës.




Grafik 3: Ecuria e primit të shkruar bruto në vite

(Në mln. lekë)



Grafik 4: Ndarja e primit të shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit, viti 2023


(Në %)



Totali i dëmeve të paguara bruto për vitin 2023 arriti në 6.96 miliardë lekë, me një rritje prej 1.77%, krahasuar me vitin 2022. Dëmet e paguara në sigurimin e Jo-Jetës kapën shifrën rreth 6.3 miliardë lekë, ndërsa në sigurimet e Jetës dëmet e paguara ishin rreth 283 milionë lekë. Pjesa tjetër prej rreth 383 milionë lekë të dëmeve të paguara i përkasin dëmeve të Fondit të Kompensimit dhe dëmeve të paguara, si sigures i drejtpërdrejtë. Dëmet e paguara Fond Kompensimi në vitin 2023, kanë shënuar një realizim pagesash prej rreth 111.22%, duke rezultuar me një tepriçë prej rreth 28 milionë lekësh nga detyrimi i Fondit të Kompensimit të miratuar nga Autoriteti për vitin 2023.

Grafik 5: Ecuria e dëmeve të paguara bruto në vite

(Në mln. lekë)



1.3 Tregu i Fondeve të Pensionit Privat

Gjatë vitit 2023 tregu i fondeve të pensionit privat ka vijuar tendencën në rritje, si në aspektin e kontributeve të derdhura, të aktiveve nën administrim, ashtu edhe në numrin e anëtarëve dhe çmimit të kuotës për secilin fond.

Në tregun e fondeve të pensionit privat ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde pensioni, dy nga të cilat kanë nisur aktivitetin e tyre gjatë vitit 2023. Fondet e pensionit administrohen nga katër shoqëri administruese, të cilat krahas administrimit të fondeve të pensionit janë të licencuar të administrojnë dhe sipërmarrje të investimeve kolektive. Me gjithë ecurinë pozitive, rritja e pjesëmarrjes në fondet e pensionit privat përbën sfidë për zhvillimin e këtij tregu.

Viti 2023 ishte një vit i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të legjislacionit në fushën e fondeve të pensionit privat. Autoriteti përfundoi hartimin e ligjit “Për fondet e pensionit privat”, i përafëruar në një nivel të lartë me Direktivën (BE) 2016/2341 (IORP II). Kuvendi i Shqipërisë në muajin shtator 2023 miratoi Ligjin nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, i cili hyri në fuqi më 6 nëntor 2023. Me hyrjen në fuqi të ligjit, Autoriteti ka vijuar me procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të tij, disa prej të cilave kanë kaluar dhe fazën e miratimit.



2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Tregu i Fondeve të Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike

2.1.1 Pozicioni financiar


Gjatë vitit 2023, në tregun e SIK ushtruan aktivitetin e tyre njëmbëdhjetë fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Këto fonde investimesh janë administruar nga pesë shoqëri administruese, tre nga të cilat krahas administrimit të SIK kryejnë edhe veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat.

Aktivitet neto të tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike janë në vlerë 45.45 miliardë lekë në 31.12.2023, me një rritje rreth 4 miliardë lekë, ose 9.62%, krahasuar me vitin 2022. Në 31.12.2023 numri i investitorëve në fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 32,181 duke shënuar një rritje prej 11.16% gjatë këtij viti.

Në grafikët e mëposhtëm janë pasqyruar ecuria e aktiveve neto dhe ecuria e aktiveve totale të tregut të fondeve të investimit gjatë pesë viteve të fundit.

Grafik 6: Aktivitet neto të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë

(Në mln. lekë)



Investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike konsistojnë në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., bono thesari të Qeverisë së R.SH., obligacione të shoqërive brenda dhe jashtë vendit, kuota në fonde investimi, si dhe aksione në shoqëri të huaja.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ecuria e portofolit të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas periudhave tremujore, për vitin 2023.

Tabelë 3: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas periudhave tremujore, 2023 *(Në mln. lekë)*

Përshkrimi	Vlera			
	31.03.2023	30.06.2023	30.09.2023	31.12.2023
Periudha				
Asetet neto të fondeve	41,995	43,298	44,757	45,455
Totali i asetëve të fondeve	42,068	43,375	45,280	45,557
nga të cilët:				
Obligacione Qeveritare (vendase dhe të huaja)	30,320	31,472	31,685	29,432
Obligacione të Shoqërive	555	574	621	551
Bono Thesari	3,510	3,324	4,295	6,696
Investime në kuota të fondeve të investimit	1,359	1,188	1,184	1,056
Aksione në shoqëri të huaja	417	434	447	464
Mjete Monetare	5,426	5,832	6,615	6,812
Asete të tjera	480	552	434	547
Totali i Detyrimeve të Fondeve	73	77	524	102

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike gjatë vitit 2023 kundrejt vitit 2022, si dhe pesha që zë secili nga instrumentet financiarë të portofolit në totalin e aktiveve në vitin 2022 dhe në vitin 2023.


Tabelë 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, 31.12.2022 - 31.12.2023

Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'22	31.12.'23		31.12.'22 31.12.'23	31.12.'22 31.12.'23
Periudha					
Asetet neto të fondit	41,466	45,455	9.62	-	-
Totali i asetëve të fondeve	41,712	45,557	9.22	100	100
nga të cilët:					
Obligacione Qeveritare (të R.SH. dhe të huaja)	27,862	29,432	5.63	66.80	64.60
Obligacione të Shoqërive	556	551	-0.95	1.33	1.21
Bono Thesari	3,930	6,696	66.66	9.42	14.70
Investime në kuota të fondeve të investimit	1,343	1,056	-21.35	3.22	2.32
Aksione në shoqëri të huaja	395	464	54.37	0.95	1.02
Mjete Monetare	7,136	6,812	-4.54	17.11	14.95
Asete të tjera	490	547	11.67	1.17	1.20
Totali i Detyrimeve të Fondeve	246	102	-58.49	0.59	0.22




Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohet struktura e aktiveve të tregut të fondeve të investimeve në vitet 2022 dhe 2023.

Grafik 7: Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2022 (Në %)



Grafik 8: Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2023 (Në %)




Shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat investojnë në tregje jo aktive, të mbajnë likuiditetin në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi.

Siç shihet në grafikun e mëposhtëm për 31.12.2023, investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në instrumente financiarë: tituj borxhi, mjete monetare e depozita, kuota të fondeve të investimit me maturim deri në një muaj, janë 20.21%, me një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2022.

Ulja e inflacionit gjatë vitit 2023 dhe stabiliteti ekonomik i vendit kanë bërë të mundur që shoqëritë administruese për fondet e investimit që ato administrojnë, të ulin nivelet e larta të likuiditetit të vitit 2022, apo të përqendronin investimet në instrumente afatshkurtra.

Grafik 9: Shpërndarja e maturimit të mbetur të instrumenteve financiare tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2023 (Në %)



2.1.2 Inspektimet

Gjatë vitit 2023, Autoriteti ka kryer inspektime të plota me bazë rreziku pranë dy shoqërive administruese, të cilat administrojnë sipërmarrje të investimeve kolektive. Objekti i këtij inspektimi ishte:

- Vlerësimi i rrezikut të pranishëm dhe zbatimi i detyrimeve rregullatore nga shoqëria administruese në kryerjen e veprimtarisë së saj;
- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në inspektimin e mëparshëm lidhur me Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

Në kuadrin e këtij inspektimi, vëmendja u përqendrua në veçanti në çështje që lidhen me menaxhimin dhe qeverisjen e shoqërisë administruese; investitorët, produktet dhe kanalet e shpërndarjes; proceset e kryerjes së aktivitetit; rreziqet dhe administrimi i kujdesshëm i tyre; funksionet e kontrollit dhe kontrollet që kryen shoqëria administruese; si dhe kapitali dhe likuiditeti. Gjatë këtij inspektimi u vlerësua gjithashtu edhe zbatimi i bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi në kryerjen e aktivitetit të shoqërisë administruese në lidhje me SIK nën administrimin e saj. Autoriteti pas çdo inspektimi ka lënë rekomandimet përkatëse, për të cilat shoqëritë administruese kanë marrë masa për zbatimin e tyre.



Tregjet e kapitalit

Rritja e rolit mbikëqyrës të Autoritetit në tregjet e kapitalit, gjatë vitit 2023 u shoqërua me miratimin e akteve të reja nënligjore, të përafuara me direktivat evropiane të fushës, të cilat vendosin standarde monitoruese dhe mbikëqyrëse për të gjithë subjektet nën mbikëqyrje. Krijimi i standardeve të raportimit për subjektet që operojnë në tregjet e kapitalit i shërben procesit analizues të veprimtarisë së këtyre subjekteve në përputhje me licencat që mbajnë. Gjithashtu, me përfundimin e procesit të përshtatshmërisë së subjekteve që veprojnë në tregjet e kapitalit me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020, Autoriteti gjatë vitit 2023 vijoi me inspektimet në vend, për të siguruar që veprimtaria e ushtruar nga subjektet është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Tregu i rregulluar – Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE

Që prej fillimit të aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE, në shkurt të vitit 2018, deri në dhjetor të vitit 2023 në Bursë është realizuar një vëllim tregtimi prej rreth 3.7 miliardë lekë, prej të cilave 35.1 milionë lekë i përkasin vëllimit të tregtimit të realizuar përgjatë vitit 2023. Që prej fillimit të aktivitetit të saj, Bursa ALSE ka tregtuar vetëm tituj të qeverisë shqiptare.

Për herë të parë, në vitin 2023 në Bursën Shqiptare të Titujve u pranuan për tregtim obligacionet e një institucioni financiar jo bankë të emetuara me ofertë publike, pas miratimit nga Autoriteti të prospektit për këtë emetim. Këto obligacione tregtohen vazhdimisht nga anëtarët e bursës (banka) për llogari të klientëve të tyre.

Tabelë 5: Ecuria në vite e vëllimit të tregtimit në bursë

(Në mln. lekë)

	2019	2020	2021	2022	2023
Vëllimi i tregtimit në bursë	1,474	452	3.03	348.2	35.1

Rënia e volumit të tregtimit në Bursë në vitin 2023 vjen si rezultat i mungesës së transaksioneve nga klientët profesionistë, që tregtojnë në volume më të larta se klientët individë, si dhe nga përdorimi i tregut OTC (tregu jashtë burse) për realizimin e transaksioneve në titujt e qeverisë. Bursa Shqiptare e Titujve numëron aktualisht 3 anëtarë (banka), të cilët kryejnë transaksione për llogari të portofolit të tyre dhe për llogari të klientëve. Në totalin e transaksioneve të kryera me titujt e Qeverisë gjatë vitit 2023 dominuan transaksionet në obligacione thesari, të kryera në monedhën lekë dhe për llogari të klientëve individë.

Infrastruktura e pastregtimit


Infrastruktura e pastregtimit është bërë plotësisht funksionale në muajin mars 2021 me pranimin e shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG”, si pjesëmarrës indirekt në sistemin AIPS të Bankës së Shqipërisë, i cili është sistem i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe. Ky anëtarësim i ALREG si pjesëmarrës në këtë sistem, mundëson procesin që lidhet me finalizimin e shlyerjes së transaksionit me tituj. ALREG ka regjistruar obligacione të emetuara me ofertë private dhe disa aksione. Me miratimin e ofertës së parë publike në 2023, ALREG ka regjistruar dhe ka kryer me sukses funksionin e klerimit dhe shlyerjes së obligacioneve korporative të emetuara nga një institucion financiar jo bankë.


Shoqëria ALREG, që prej licencimit të saj në vitin 2019, ka regjistruar 28 emetime të obligacioneve me ofertë private, me një vlerë prej rreth 17.9 miliardë lekë. Gjatë vitit 2023, ALREG ka regjistruar 9 emetime në shumën rreth 8.1 miliardë lekë. Obligacione të emetuara përmes ofertës publike të regjistruara në ALREG janë në vlerën 500 milionë lekë.

Tregu i obligacioneve me ofertë private

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private është konsoliduar me rritje të konsiderueshme vit pas viti. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti nga rreth 14 miliardë lekë në fund të vitit 2022, në rreth 20 miliardë lekë në fund të vitit 2023, me një rritje prej rreth 46%. Aktualisht në treg janë 11 emetues aktivë të obligacioneve me ofertë private, nga të cilët 7 banka, 2 institucione mikrokredie dhe 2 shoqëri tregtare. Përgjatë vitit 2023, Autoriteti ka regjistruar 10 akt-oferta të përgatitura nga 6 emetues (4 banka dhe 2 institucione mikrokredie). Edhe gjatë vitit 2023 bankat kanë vijuar të jenë emetuesit më të shpeshtë për qëllim të kapitalit rregullator.

Grafik 10: Gjendja e pashlyer e obligacioneve të emetuara me ofertë private (Në mln. lekë)





Tregu i obligacioneve me ofertë publike

Gjatë vitit 2023, një institucion financiar jo bankë emetoi obligacione nëpërmjet ofertës publike. Oferta publike u realizua me sukses duke u mbyllur me nënshkrimin e të gjithë shumës së ofruar prej 500 milionë lekë. Kjo është hera e parë, që titujt e një shoqërie ofrohen për publikun, duke shënuar një moment të rëndësishëm për këtë treg, si dhe duke shërbyer si model për emetime të kësaj natyre edhe nga subjekte të tjera, me qëllim sigurimin e aksesit në kapital përmes ofrimit të alternativave të reja të financimit përtej financimit tradicional të siguruar nga sistemi bankar.

Inspektimet

Pas përfundimit të procesit të përshtatshmërisë së subjekteve që veprojnë në tregjet e kapitalit, Autoriteti gjatë vitit 2023, kreu dy inspektime tematike në vend pranë dy subjekteve (banka) për të vlerësuar përputhshmërinë e këtyre subjekteve me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për tregjet e kapitalit. Inspektimi u fokusua në:

- Vlerësimin e veprimtarisë dhe respektimit të kërkesave ligjore e rregullatore për shërbimin e marrjes dhe transmetimit të urdhrave si dhe ekzekutimit të urdhrave në emër të klientëve;
- Vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit për kryerjen e këtij shërbimi;
- Verifikimin e procedurave për kryerjen e shërbimit ndihmës të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve (shërbimi i kujdestarisë);
- Zbatimin e procedurave për certifikimin e personave kyç.

Në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet iu komunikuan subjekteve dhe zbatimi i tyre ndiqet në vijimësi nga Autoriteti.

2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

2.2.1 Pozicioni financiar

Autoriteti, gjatë vitit 2023, ka mbikëqyrrur dhe ndjekur në vazhdimësi dinamikën e tregut të sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive në nivel individual dhe në tërësi të gjithë tregut të sigurimeve. Autoriteti ka vijuar ndjekjen e përmbushjes së kërkesave ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Tabelë 6: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivet*

(Në mln. lekë)

	31.12' 19	31.12' 20	31.12' 21	31.12' 22	31.12' 23
Totali i aktiveve	38,803	38,865	40,571	43,550	50,636
Jeta	4,105	4,814	5,075	5,264	5,662
Jo-Jeta	34,699	34,051	35,496	38,286	44,975
Totali i investimeve	22,151	25,029	27,585	30,575	36,890
Jeta	3,578	4,258	4,401	4,473	4,823
Jo-Jeta	18,574	20,770	23,184	26,102	32,068

Në aktivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Insig Jetë sh.a. dhe Albsig sh.a. tek Albsig Jetë sh.a.


Në 31.12.2023, totali i aktiveve të tregut të sigurimeve është rreth 50.6 miliardë lekë, ku 89% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 11% i përkasin shoqërive të tregut të Jetës. Për këtë periudhë, aktivet kanë pësuar një rritje prej 7 miliardë lekë, ose rreth 16% krahasuar me 31.12.2022.

Rritja e totalit të aktiveve është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorit të Jo-Jetës, me rreth 6.7 miliardë lekë, ose rreth 17% më shumë, krahasuar me 31.12.2022. Edhe sektori i Jetës ka pësuar rritje të totalit të aktiveve me rreth 398 milion lekë, ose 8% krahasuar me 31.12.2022. Kjo rritje për të dy sektorët ka ardhur si rezultat i performancës financiare pozitive të shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2023 dhe rritjes së zërit të investimeve.



Grafik 11: Totali i aktiveve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite

(Në mln. lekë)




Për sektorin e Jo-Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 6 miliardë lekë, ose 21% më shumë krahasuar me 31.12.2022.

Për sektorin e Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 349 milionë lekë, ose 8% më shumë krahasuar me 31.12.2022.

Për tregun e sigurimeve në tërësi, edhe në 31.12.2023 investimet kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve, me vlerë 36.9 miliardë lekë, duke zënë rreth 73% të totalit të tyre. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është rreth 6.3 miliardë lekë ose 21% më shumë.

Grafik 12: Totali i investimeve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite

(Në mln. lekë)



Zhvillimet kryesore në strukturën e aktiveve për të dy sektorët e tregut të sigurimeve, krahasuar me 31.12.2022, paraqiten si më poshtë:


Depozitat vazhdojnë të zënë peshën kryesore të aktiveve me rreth 32%, ndjekur nga zëri “Toka dhe ndërtesa” dhe “Bono thesari dhe obligacione”, përkatësisht me rreth 13.2% dhe 12.5%. Krahasuar me 31.12.2022, depozitat janë rritur me 2.1 miliardë lekë, ose 15%. Me rritje paraqitet edhe zëri debitorë prej 19%, ose 533 milionë lekë, ndikuar nga rritja e debitorëve të tregut të Jo-Jetës në masën 20%, ose 515 milionë lekë.



Më poshtë, paraqitet grafikisht ecuria e strukturës së aktiveve për periudhën 31.12.2019 deri më 31.12.2023.

Grafik 13: Struktura e Aktivit për tregun e sigurimeve 2019-2023

(Në %)



Tabelë 7: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi*

(Në mln. lekë)

	31.12.'19	31.12.'20	31.12'21	31.12'22	31.12'23
Totali i Pasivit	38,803	38,865	40,571	43,550	50,636
Jetë	4,105	4,814	5,075	5,264	5,662
Jo-Jetë	34,699	34,051	35,496	38,286	44,975
Provigjonet teknike bruto	22,100	20,986	22,020	23,690	25,307
Jetë	1,902	2,031	2,236	2,414	2,490
Jo-Jetë	20,199	18,956	19,783	21,276	22,817
Totali i kapitaleve të veta	11,145	12,651	13,059	13,680	17,280
Jetë	2,019	2,419	2,454	2,366	2,713
Jo-Jetë	9,126	10,232	10,605	11,314	14,567
Totali i kapitalit të nënshkruar	7,366	7,473	7,743	7,783	9,542
Jetë	1,632	1,882	1,882	1,882	1,891
Jo-Jetë	5,734	5,591	5,861	5,901	7,651**


* Në pasivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Insig Jetë sh.a. dhe Albsig sh.a. tek Albsig Jetë sh.a.

** Kërkesa për rritjen e kapitalit të një shoqërie sigurimi Jo-Jetë është në proces shqyrtimi nga Autoriteti.


Struktura e pasiveve të tregut të sigurimeve vijon të dominohet nga zërat e provigjoneve teknike me 50%, si dhe “Kapitalet e veta”, të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e shoqërisë, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve me 34%, ndërkohë që pjesa tjetër e pasivit janë detyrimet e tjera me 16%. Rritja e totalit të pasiveve për tregun e sigurimeve gjatë vitit 2023 është ndikuar kryesisht nga rritja kapitaleve të veta të shoqërive, me 3.6 miliardë lekë, ose me rreth 26%, si efekt i rritjes së fitimit neto për periudhën dhe fitimeve të mbartura.

Grafik 14: Struktura e Pasivit për tregun e sigurimeve


(Në %)



Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2023 për tregun e sigurimeve janë në vlerën rreth 37.5 miliardë lekë, nga të cilat 34.2 miliardë lekë janë aktive të tregut të sigurimit të Jo-Jetës dhe rreth 3.2 miliardë lekë aktive të tregut të sigurimit të Jetës. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, në këtë periudhë është rritur në nivelin 150%, nga 133.5% që ishte në 31.12.2022. Ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jetës, mbulimi i provigjoneve matematike në 31.12.2023 rezulton 129.64% nga 118.3% që ishte në 31.12.2022.



Grafik 15: Struktura e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike* (Në %)




Rezultati financiar

Gjatë vitit 2023, tregu i sigurimeve ka pasur një ecuri pozitive. Në tërësi rezultati financiar për 31.12.2023 ka rezultuar në vlerën 2.78 miliardë lekë. Respektivisht tregu i Jo-Jetës ka rezultuar me 2.46 miliardë lekë fitim dhe tregu i Jetës me 323 milionë lekë fitim. Rezultati financiar në tregun e Jo-Jetës për vitin 2023 është ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 21 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet operative janë mbajtur në të njëjtat nivele me vitin e kaluar. Ecuri pozitive ka patur dhe në të ardhurat nga investimet, të cilat kanë rezultuar në vlerën 677 milionë lekë, ndikuar kryesisht nga rritja e normave të interesit, dividendët, etj. Gjithashtu edhe në tregun e Jetës rezultati financiar, është ndikuar nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 1.86 miliardë lekë.

* Aktivët në mbulim të provigjoneve teknike janë aktivët e shoqërisë së sigurimit të cilat shërbejnë për mbulimin e përgjegjësive të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe që mbulojnë humbje si pasojë e rreziqeve që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit për të cilat kjo e fundit detyrohet të krijojë provigjone teknike.

Grafik 16: Rezultati financiar për tregun e sigurimit të Jo-Jetës dhe Jetës


(Në mln. lekë)



Raporti dëme/prime: Dëmet e paguara pa përfshirë pagesën e dëmeve nga risiguruesit (dëmet neto) në raport me primet e fituara neto në 31.12.2023, për tregun e Jo-Jetës rezultuan në nivelin 35.2% nga 36.3% një vit më parë. Për tregun e Jetës raporti dëme/prime neto për 31.12.2023 është 18.8% nga 18.7% në 31.12.2022

Graik 17: Raporti dëme/prime për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës

(Në %)






Raporti i shpenzimeve, përfaqëson raportin midis shpenzimeve operative neto dhe shpenzimeve të tjera neto për sigurimet kundrejt primeve të fituara neto. Për tregun e Jo-Jetës ky raport për 31.12.2023 rezulton rreth 52.8%, nga 55.2% në 31.12.2022. Shpenzimet në vitin 2023 kanë pësuar një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2022 për tregun e Jo-Jetës. Për tregun e Jetës raporti i shpenzimeve për 31.12.2023 është 67.2%, nga 69.4% që ka qenë një vit më parë, duke rezultuar me një rënie prej rreth 2.2%.

Grafik 18: Raporti i shpenzimeve për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës

(Në %)



Mbikëqyrja në distancë

Në zbatim të kuadrit rregullator, Autoriteti ka ushtruar mbikëqyrje në distancë nëpërmjet monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raportimeve të depozituara nga shoqëritë e sigurimit dhe institucione të tjera. Mbikëqyrja në distancë fokusohet tek përpunimi dhe analiza e informacionit të mbledhur nga raportimet periodike apo *ad-hoc* të shoqërive të sigurimit, me theks të veçantë tek analizat financiare dhe aktuariale. Konkretisht, në fokus të mbikëqyrjes në distancë për periudhën raportuese ishin:

- Përgatitja e raporteve të analizave financiare në distancë për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë për periudhat tremujore, bazuar në shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të dërguara nga raportimet e shoqërive të sigurimit, si dhe në informacionet nga inspektimet në vend dhe analizat financiare të mëparshme;
- Shqyrtimi i raporteve të audituesve të jashtëm për shoqëritë e sigurimit dhe grupet e sigurimit për veprimtarinë e tyre gjatë vitit paraardhës;
- Monitorimi mujor i ecurisë të normës së likuiditetit për shoqëritë e sigurimit;
- Shqyrtimi i raporteve vjetore të audituesve të brendshëm të shoqërive të sigurimit;
- Shqyrtimi i planeve vjetore të biznesit të shoqërive;
- Monitorimi i publikimit të raportit vjetor të shoqërive;
- Analizimi i raporteve të vetëvlerësimit për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë;
- Llogaritja me bazë tremujore e provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe llogaritja e kufirit minimal të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit;
- Analizimi i marrëveshjeve të risigurimit dhe vlerësimi i cilësisë së risiguruesve;
- Monitorimi i rreziqeve me vlerë mbi 10% të kapitalit për çdo rrezik të veçantë dhe monitorimi i dëmeve mbi 10 milionë lekë;
- Llogaritja e primit të rrezikut në nivel tregu, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik, në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi.

Implementimi i SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”

Me qëllim marrjen e masave nga shoqëritë e sigurimit për zbatimin e SNRF 17, shoqëritë e sigurimit, si njësi ekonomike me interes publik, hartojnë dhe raportojnë pasqyrat financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), pjesë e të cilave është edhe SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”. Autoriteti, me vendimin e Bordit nr. 146, datë 31.08.2023 ka miratuar “Udhëzimin mbi raportimin e shoqërive të sigurimit për zbatimin e SNRF 17 Kontratat e sigurimit”.



Vlerësohet se zbatueshmëria e SNRF 17 parashikohet të ketë efekt të gjerë mbi paraqitjen e pasqyrave financiare, si dhe të sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në metodologjinë e llogaritjes së provigjoneve dhe vlerësimin e tyre. Krahas vlerësimit të provigjoneve me vlerë tregu, përfshihen edhe koncepte të reja, si: marzhi i shërbimit kontraktor, rregullimi i rrezikut, etj., zbatimi i SNRF 17 pritet të ketë efekt edhe në pasqyrat financiare, përfshirë edhe rezultatin financiar të shoqërive të sigurimit.

Autoriteti është i angazhuar në monitorimin e zbatimit të planit të punës për implementimin e SNRF 17, si dhe raportimet e shoqërive lidhur me kërkesat e këtij standardi.

Udhërrëfyeni për implementimin e regjimit mbikëqyrës Solvency II

Zbatimi i Solvency II është një nga prioritetet kryesore të Autoritetit në kuadër të përgatitjeve të vendit për anëtarësimin në BE. Solvency II pritet të sjellë një ndryshim të konsiderueshëm në kulturën e administrimit të rrezikut nga ana e shoqërive të sigurimit. Kapitalizimi i mirë i siguruesve do t'i mundësojë sektorit përballimin e goditjeve të paparashikuara. Objektivat kryesore të Solvency II janë: përmirësim i mbrojtjes së konsumatorit; mbikëqyrje e modernizuar; rritja e konkurrencës ndërkombëtare të siguruesve të BE-së; koherencë me standardet ndërkombëtare të raportimit dhe kontabilitetit; harmonizimi dhe integrimi më i thellë i tregut të BE-së.

Autoriteti me konsulencën e Bankës Botërore ka miratuar me Vendim Bordi nr. 2, datë 26.01.2023 një udhërrëfyes për implementimin e regjimit të Solvency II në vendin tonë. Synimet kryesore të udhërrëfyesit janë:

- Vlerësimi i pasqyrave financiare të tregut për të evidentuar devijimet nga regjimi aktual;
- Kryerja e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për të tre shtyllat;
- Zhvillimi i mjeteve të nevojshme për ushtrimin e OIS *Quantitative Impact Study*;
- Zhvillimi i ORSA-s duke përfshirë formatet dhe mjetet përkatëse;
- Hartimi i ligjit të ri të sigurimeve dhe rregulloreve përkatëse bazuar në kërkesat e BE-së;

- Përcaktimi i specifikimeve për sistemin rregullator të IT-së në përputhje me Solvency II (duke përfshirë fleksibilitetin ndaj ndryshimeve të mundshme);
- Zhvillimi i kapaciteteve të duhura mbikëqyrëse për zbatimin e Solvency II.

Ky regjim i ri mbikëqyrës parashikon hartimin e një raporti të veçantë vjetor lidhur me aftësinë paguese dhe gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, si dhe një raport për qëllime mbikëqyrëse, i quajtur Regular Supervisory Report (RSR).

Nga momenti i fillimit të aplikimit të udhërrëfyesit, aktivitetet përgatitore janë planifikuar të shtrihen në pesë vjet, ndërkohë që viti i gjashtë është planifikuar për miratimin e rregulloreve dhe do të shërbejë gjithashtu si një vit ushtrimor, ku siguruesit do të raportojnë Solvency II së bashku me rregulloren aktuale të aftësisë paguese. Ndërsa viti i fundit (i shtatë) është edhe viti i fillimit të zbatimit të sistemit rregullator Solvency II.

Autoriteti vlerëson të rëndësishëm edhe rolin e shoqërive të sigurimit në këtë proces dhe për këtë në trajnimet e parashikuara si pjesë e projektit SECO III, i zhvilluar me asistencën e Bankës Botërore do të ftohen dhe përfaqëues të shoqërive të sigurimit.

Struktura e kuadrit rregullator Solvency II

- **Shtylla 1 përcakton kërkesat sasiore**, duke përfshirë rregulla për vlerësimin e aktiveve, detyrimeve (në veçanti të provigjoneve teknike), llogaritjen e kërkesave për kapital, si dhe identifikimin e fondeve të veta, të përshtatshme, për të këto kërkesa.
- **Shtylla 2 përcakton kërkesat cilësore**, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, sistemet e qeverisjes, si dhe sistemin e vetëvlerësimit të rrezikut të aftësisë paguese (ORSA) me planifikim dhe menaxhim të kujdesshëm të kapitalit, teste stresi dhe skenarësh, me qëllim garantimin e aftësisë paguese në çdo kohë.
- **Shtylla 3 mbulon raportimin mbikëqyrës dhe informimin publik** të palëve të treta. Shoqëritë duhet të bëjnë publike detajet e rreziqeve që ata marrin përsipër, mjaftueshmërinë e tyre të kapitalit dhe masat e administrimit të rrezikut që kanë përshtatur. Transparenca dhe dhënia e informacionit synojnë vendosjen e një disipline të duhur në treg.



2.2.2 Inspektimet

Inspektime të plota me fokus rrezikun

Gjatë vitit 2023, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend tek dy nga shoqëritë e sigurimit të Jetës, sipas metodologjisë me fokus rrezikun. Inspektimet me bazë rreziku përqendrohen në vlerësimin e rreziqeve kryesore, ndaj të cilave ekspozohen shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit, si dhe administrimi dhe zbutja e këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë, duke vlerësuar përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit, në drejtim të ruajtjes së shëndetit financiar të saj.

Këto inspektime synojnë vlerësimin e rrezikut të kreditit, të sigurimit, operacional, ligjor/rregullator dhe strategjik, si dhe vlerësimin e cilësisë së kapitalit, fitimeve dhe elementeve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë. Gjithashtu në fokus të këtyre inspektimeve është dhe vlerësimi i menaxhimit të rrezikut, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe rolin e niveleve drejtuese të shoqërisë në veprimtarinë e saj.

Në përfundim të inspektimit, Autoriteti vlerësoi rrezikun për çdo aktivitet të shoqërisë së sigurimit dhe përditësoi profilin e rrezikut të saj. Profili i rrezikut shërben si bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe shpërndarjen e kapaciteteve të duhura sipas nivelit të ekspozimit të rrezikut.

Inspektime tematike

Gjatë vitit 2023, janë kryer shtatë inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës të fokusuar në çështje që lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen e konsumatorëve dhe verifikimin e vijueshmërisë së ndjekjes së zbatim të rekomandimeve të lëna nga Autoriteti në inspektimet paraardhëse, si dhe të të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Verifikimi i procedurave dhe afateve për dëmshpërblim, kryesisht për dëmet e sigurimit të detyrueshëm motorik, zbatimi i rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit, etj., kanë qenë objekt i pesë prej inspektimeve tematike të kryera, ku u verifikuan:

- Zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi, standardeve dhe procedurave operacionale të administrimit të dokumentacionit të dëmeve, sipas linjës së raportimit dhe nivelit të kompetencave, kryesisht për dëmet pezull dhe të paguara;

- Trajtimi i ankesave për dëmshpërblim;
- Saktësia e raportimit në Autoritet të provigjoneve teknike të dëmeve, etj.

Gjithashtu, në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi dhe kushteve të përgjithshme të miratuara nga Autoriteti për kontratat e lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit janë kryer tre inspektime të tematike, me qëllim shqyrtimin e procesit të marrjes në sigurim për këtë përgjegjësi, fokusuar në:


- Verifikimin e përputhshmërisë së elementëve dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të lëshuara gjatë periudhës objekt inspektimi;
- Procedurat e brendshme të marrjes në sigurim dhe përgjegjësitë e kontraktuara nga shoqëria e sigurimit;
- Mbulimin me risigurim për kontratat e sigurimit të lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit.

Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti iu komunikoi shoqërive të sigurimit gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, duke adresuar me vendime Bordi problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për zbatimin e tyre. Ndjekja dhe zbatimi i këtyre vendimeve monitorohet në vijimësi nga Autoriteti, në drejtim të respektimit të afateve dhe përmbushjes së kërkesave të tyre.

2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve

Në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti kryen mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi. Grupi i sigurimit, për qëllime të mbikëqyrjes, përbëhet nga dy ose më shumë persona juridikë, ku të paktën njëri është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi i rëndësishëm përcaktohet bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontraktuale, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksionet brenda grupit.

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri, gjatë vitit 2023, kanë ushtruar veprimtari katër grupe sigurimi, nga të cilat dy grupe janë me kapital vendas dhe dy të tjerat me kapital të huaj.



Mbikëqyrja efektive e grupeve të sigurimit, bazohet në parimet themelore të sigurimeve (*International Core Principles*), të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), si dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga Autoriteti me mbikëqyrësit e vendeve ku ushtrojnë veprimtarinë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtar që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri.

Në vitin 2023, janë kryer takime në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimeve, Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group. Këto kolegje zhvillohen në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Autoriteti raportoi mbi mbarëvajtjen dhe performancën e shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri.

Autoriteti, ka vijuar edhe me takime me përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse rajonale për dy grupe në sigurime, në cilësinë e Autoritetit rregullator të shoqërive mëmë të grupeve të sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe në Republikën e Kosovës. Në këto kolegje janë diskutuar ecuria e shoqërive të sigurimit dhe çështje të tjera me interes të përbashkët për dy rregullatorët.

2.2.4 Provigjonet Teknike

Në vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, një tregues i rëndësishëm është niveli i provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit nga shoqëritë e sigurimit.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje, duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Në fund të vitit 2023, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitetin Jetë dhe Jo-Jetë janë rreth 25.31 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2022, ku vlera e provigjoneve bruto në nivel tregu rezultoi rreth 23.72 miliardë lekë, në vitin 2023 vihet re një rritje e vlerës së provigjoneve teknike bruto në nivel tregu, me rreth 6.7% ose rreth 1.59 miliardë lekë, e ndikuar nga të dy aktivitetet.


Për aktivitetin e Jo-Jetës rritja rezulton të jetë rreth 1.51 miliardë lekë, ose rreth 7.1%, ndërsa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës rezulton një rritje e provigjoneve teknike bruto me rreth 75.2 milionë lekë, ose rreth 3.1%.


Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, me 90.2% të totalit të provigjoneve teknike bruto ose rreth 22.82 miliardë lekë. Ndërsa provigjonet teknike bruto për aktivitetin e Jetës arrijnë në 2.49 miliardë lekë, ose 9.8% e totalit. Kjo strukturë reflekton gjithashtu edhe raportin e primeve të shkruara bruto për aktivitetin e Jo-Jetës kundrejt atyre të Jetës, përkatësisht 91.9% dhe 8.1%.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjonit teknik të dëmeve dhe primeve.

Grafik 19: Provigjoni teknik bruto

(Në mld. lekë)





Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

Provigjonet teknike përfshijnë:

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësive për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)

Provigjoni teknik bruto për produktet MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues, për 31.12.2023, arrin në rreth 15.13 miliardë lekë, duke pësuar kështu një rritje me rreth 6.76% krahasuar me vitin e kaluar. Pesha e provigjoneve teknike bruto për portofolin e MTPL është 66%, pothuajse në të njëjtat nivele si në fund të vitit 2022.

Nga të dhënat për peshën dhe strukturën e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm, vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve, në krahasim me provigjoniin e primit të pafituar, duke ruajtur të njëjtën strukturë ndarjeje edhe gjatë vitit 2023. Në vazhdimësi, Autoriteti ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjoniit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm, në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni për dëmet në proces gjyqësor, lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë e sigurimit.


Tabelë 8: Pesha dhe struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm

(Në mld. lekë)

Pesha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm	2019	2020	2021	2022	2023
Provigjone bruto total MTPL	11.80	12.37	13.23	14.17	15.13
Provigjone bruto total Jo-Jeta	20.20	18.96	19.78	21.30	22.82
Pesha specifike e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun (Në %)	58	65	67	67	66
Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm (Në%)	2019	2020	2021	2022	2023
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	56	56	56	56	56
Provigjoni i Primit të pafituar MTPL	44	44	44	44	44
Provigjone bruto total MTPL	100	100	100	100	100

Aplikacioni për përlogaritjen e dëmeve ndaj personit në aksidentet rrugore

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe miratimit nga Autoriteti të Rregullores nr. 125, datë 28.07.2021, “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti zhvilloi aplikacionin e llogaritësit të dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit, i cili bazohet në disa supozime, vlerat e përlogaritura janë orientuese dhe synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit. Aplikacioni është ndërtuar për përlogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.



Risite kryesore që ka sjellë ky aplikacion për të siguruarit dhe profesionistët e fushës janë:

- Përlllogaritje automatike e vlerës së dëmit;
- Transparencë mbi vlerën e dëmit pasuror dhe dëmit jopasuror, dhe pasqyrimi i vlerës për çdo figurë dëmi;
- Edukim i konsumatorëve në fushën e sigurimeve.

Ky aplikacion ju vjen në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë profesionistëve/ ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmit dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

2.2.5 Risigurimet

Risigurimi është forma kryesore e transferimit të rrezikut, në industrinë e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe stabilitetin e këtij tregu. Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të risigurojnë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar, që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet risigurimit zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve të mëdha, përmirësojnë kërkesat për kapital (aftësi pague), rrisin mundësinë për të siguruar më shumë rreziqe, si dhe marrin asistencë teknike dhe financiare nga shoqëritë risiguroese. Aktiviteti i risigurimit është i konsoliduar, ndikuar edhe nga kërkesat e përcaktuara në Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015, “Për kriteret e risigurimit”, e ndryshuar.

Në bazë të kërkesave ligjore dhe rregullatore, shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet programin vjetor të risigurimit. Bazuar në funksionin e tij mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave të lidhura, duke synuar stabilitetin e vazhdueshëm financiar, në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriterëve të lidhura me cilësinë e risiguroesve.

Marrëveshjet e risigurimit, në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës, janë të formës joproporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2023 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve, në vlerë rreth 3.57 miliardë lekë, ose sa 15.59% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, në nivel tregu, është rritur me rreth 352 milionë lekë, ose rreth 10.94%, krahasuar me fundvitin 2022;
- Për aktivitetin e Jo-Jetës në vlerën rreth 3.45 miliardë lekë, ose sa 16.42% e vlerës së primeve të shkruara bruto. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, për gjithë aktivitetin e Jo-Jetës, është rritur me rreth 326.71 milionë lekë, ose rreth 10.45%, krahasuar me fundvitin 2022;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën rreth 115 milionë lekë, ose sa 6.18% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës. Primet e ceduara në risigurim për sigurimin e Jetës, janë rritur me rreth 25.22 milionë lekë, ose 28.11%, krahasuar me fundin e vitit 2022.

Në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022, konstatohet rritje e primeve të ceduara në risigurim pothuajse në të gjithë portofolet. Për vitin 2023, peshën më të madhe ndaj primeve totale të ceduara, e zënë produktet “Motorike” me rreth 53.13% të totalit dhe “Zjarri dhe të tjera të pronës” me rreth 33.67%.


Tabelë 9: Primet e ceduara në risigurim sipas portofoleve kryesore, 2022 dhe 2023

(Në mln. lekë)

<i>Lloji i Sigurimit</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>
Aksidente dhe shëndet	52	43
Motorike	1,720	1,835
Zjarri e të tjera të pronës	987	1,163
Përgjegjësi	175	187
Të tjera	192	226
Total	3,127	3,453



Grafik 20: Peshat specifike e risigurimeve sipas portofoleve kryesore për vitin 2022 krahasuar me vitin 2022 (Në %)



Në bazë dhe për zbatim të Rregullores nr. 57, datë 26.05.2017 “Mbi llogaritjen e Mbjatjes Neto të Mbulimit Maksimal Agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”, referuar ekspozimit më 31.12.2023, shoqëritë e sigurimit kanë raportuar dhe normën e mbajtjes agregate neto për sigurimin nga tërmeti. Bazuar në marrëveshjet e risigurimit në fuqi, tregu i sigurimeve mund të përballojë, pa cënuar treguesit financiarë, dëme deri në rreth 200 milionë euro. Risigurimi është kryer në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 “Për kriteret e risigurimit”, e ndryshuar.

Referuar agjencive klasifikuese Standard & Poors, Fitch, Moody’s, etj., cilësia e risiguruesve kryesorë të marrëveshjeve që mbulojnë aktualisht risqet e ceduara në risigurim nga shoqëritë e sigurimit rezulton së paku në kategorinë e vlerësimit A, që do të thotë edhe më cilësore nga sa kërkohet nga kuadri rregullator në fuqi.

Praktika e ushtruar nga shoqëritë e sigurimit, si dhe mbikëqyrja nga ana e Autoritetit për aktivitetin e risigurimit, si element i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut, u vlerësua nga Ekipi i Ekspertëve të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), në përputhje të plotë me parimet ndërkombëtare themelore të sigurimeve, të miratuara nga IAIS.

Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Raporti i vetëvlerësimit të rrezikut dhe aftësisë paguese (*Own Risk and Solvency Assessment – ORSA*) dorëzohet në Autoritet, me një frekuencë vjetore, nga çdo shoqëri që ushtron aktivitet në klasat e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës. Detyrimi për raportim periodik parashikohet në Rregulloren nr.18, datë 28.4.2015, “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”. Ky detyrim është, gjithashtu, në përputhje me standardet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS).

Kriteret mbi përmbajtjen e raportit përcaktohen në nenin 12 të rregullores, duke siguruar kështu një formë standarde të raportit dhe krahasueshmëri të informacionit të paraqitur. Çdo raport pasqyron në mënyrë të plotë elementët e mëposhtëm:

- Kuadrin e administrimit të rrezikut;
- Kategoritë e rreziqeve;
- Kuadrin e raportimit;
- Administrimin e kapitalit;
- Rreziqet e identifikuara dhe vlerësimin e tyre;
- Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara;
- Rekomandimet dhe masat;
- Proflin e përgjithshëm të rrezikut.

Ky raport lejon Autoritetin të vlerësojë në mënyrë objektive ekspozimin e çdo shoqërie sigurimi ndaj rreziqeve me materialitet të lartë, masat e saj të kontrollit, si dhe efikasitetin e këtyre masave, me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit, si në nivel shoqërie sigurimi ashtu dhe tregu në përgjithësi.

Për vitin 2023, shoqëritë u shprehën se dinamikat e tregut, pas Covid-19, kanë lënë vend për evidentimin dhe përballjen me rreziqe të reja, ku primar vazhdon të jetë rreziku kibernetik. Rreziqet me materialitetin më të lartë të evidentuar nga siguruesit janë edhe rreziku i kreditit, rreziku i tregut, rreziku i likuiditeti, rreziku operacional, rreziku i marrjes në sigurim.

Në kuadër të përafrimit të pjesshëm me direktivën Solvency II, Autoriteti ka filluar punën për amendimin e Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ku një ndër kapitujt që priten të rishikohen kanë të bëjnë me Sistemin e Administrimit të Rrezikut, me fokus Raportin Vjetor të Vetëvlerësimit të Rrezikut dhe Aftësisë Paguese (ORSA).



2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit

Fondi i Kompensimit për vitin 2023


Fondi i Kompensimit në mbyllje të vitit financiar 2023, rezulton me një vlerë të paguar rreth 286 milionë lekë, ose me një realizim prej 111.22 %, të detyrimit të fondit për vitin 2023.

Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 7, datë 26.01.2023, ka miratuar Fondin e Kompensimit për vitin 2023 në vlerën 276 milionë lekë, nga të cilat balanca e Fondit të Kompensimit më 31.12.2022, ka rezultuar me tepëri rreth 19 milionë lekë. Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) ka pasqyruar, llogaritur dhe shpërndarë Fondin e Kompensimit për vitin 2023 sipas shoqërive të sigurimit, anëtare të saj.

Duke krahasuar të dhënat e raportuara, rezulton se dëmet objekt Fond Kompensimi pezull më 31.12.2023 janë ulur në numër me 137 dëme, të cilat janë në vlerë 138,413,797 lekë. Pjesë e konsiderueshme e dëmeve pezull janë dëmet në proces gjyqësor, që i përkasin ngjarjeve përpara hyrjes në fuqi të Ligjit 32/2021 (datë ngjarjeje para 1 korrik 2021), të cilat rezultojnë në vlerën 536,187,875 lekë, ose rreth 87.36% të dëmeve në proces.

Grafik 21: Ecuria e pagesave Janar-Dhjetor 2023

(Në mln. lekë)



Gjatë vitit 2023, shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së, përveç pagesave të detyrimeve të Fondit të miratuar, kanë kryer edhe pagesa si sigurues të drejtpërdrejtë në funksion të entit kompensues, për dëme shkaktuar nga mjete të pasiguruara/paidentifikuara, në vlerën rreth 96 milionë lekë, sipas kërkesave të nenit 43, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Klasifikimi i rasteve që trajtohen nga Fondi i Kompensimit dhe nga shoqëritë e sigurimit, si sigurues të drejtpërdrejtë, sipas Ligjit nr. 32/2021, ka ndikuar në uljen e Fondit të Kompensimit për rastet e parashikuara në nenin 41, të këtij ligji. Ky klasifikim ka adresuar rreth 75 % të rasteve drejtpërdrejtë tek shoqëritë e sigurimit, sipas nenit 43. Dëmet objekt Fond Kompensimi mbeten në vlera të konsiderueshme, për shkak të ngjarjeve të ndodhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Autoriteti, gjatë vitit 2023, ka kryer inspektime në vend pranë shoqërive të sigurimit dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Inspektimet pranë 8 shoqërive të sigurimit anëtare të BSHS-së, lidhen me verifikimi i pagesave të kryera dhe statusi i dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit si dhe i praktikave të dëmeve, me ngjarje sigurimi pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 për të cilat shoqëria e sigurimit kryen funksionin e entit kompensues sipas përcaktimeve të nenit 43, të Ligjit nr. 32/2021, për vitin 2023.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit janë ushtruar 2 inspektime. Inspektimet e ushtruara lidhen me:

- Verifikimin e funksionimit dhe i të dhënave të regjistrit elektronik të Byrosë Shqiptare të Sigurimit në zbatim të kërkesave të rregullores nr. 105 datë 30.06.2021 “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit si dhe i mënyrës, procedurave dhe afateve të trajtimit të praktikave të dëmeve objekt fond kompensimi, në zbatim të kërkesave të rregulloreve nr. 191, datë 26.10.2021 “Mbi administrimin e fondit të kompensimit” dhe nr. 103, datë 30.06.2021 “Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021”;
- Verifikimin e të dhënave të raportuara, për dëmet e papaguara objekt Fond Kompensimi, në zbatim të kërkesave të rregullores nr. 104, datë 30.06.2021 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit” dhe rregullores nr. 105 datë 30.06.2021 “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.

Në përfundim të inspektimit të ushtruar gjatë muajit korrik 2023, ndaj BSHS u morën masa korrigjuese, me Vendimin nr. 185, datë 27.10.2023.

Byroja Shqiptare e Sigurimit është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Monitorimi i Byrosë ka qenë në fokus të Autoritetit, veçanërisht gjatë viteve të fundit, për t’u dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite.

Aktualisht çdo anëtar i BSHS-së ka investuar në depozita me afat Fondin e Garancisë së Kartonit Jeshil në vlerën 250,000 euro, në favor të BSHS-së pranë



bankave të nivelit të dytë. Gjithashtu Byroja disponon fondin për pagesën e dëmeve të shkaktuara nga mjete me targa të huaja dhe të pajisura me Karton Jeshil, në shumën prej 500,000 euro, në një llogari qëllimore të veçantë.

Autoriteti monitoron dhe mbikëqyr në mënyrë periodike veprimtarinë e BSHS-së lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore, si nëpërmjet raportimit, ashtu dhe nëpërmjet inspektimeve në vend.

2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Privat

2.3.1 Pozicioni Financiar


Tregu i fondeve të pensionit privat që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka pasur tendencë në rritje, përsa i përket aktiveve, vlerës neto të aktiveve që administrojnë dhe numrit të anëtarëve.

Totali i aktiveve neto të këtij tregu më 31.12.2023 është 6.7 miliardë lekë me një numër prej 38,180 anëtarë. Aktivitet neto të këtij tregu kanë pësuar një rritje me 18.22% dhe numri i anëtarëve është rritur me 4.55%, krahasuar me fundin e vitit 2022.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur ecuria e aktiveve neto të tregut të fondeve të pensionit gjatë 5 viteve të fundit.

Grafik 22: Ecuria në vite e aktiveve neto të fondeve të pensionit privat

(Në mln. lekë)



Aktivet e këtij tregu në 31.12.2023 janë investuar kryesisht në obligacione të qeverisë shqiptare, të cilat përbëjnë 95.95% të totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat, me një rritje prej 17.97% krahasuar me fundin e vitit 2022. Pjesa tjetër e aktiveve të këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme. Struktura e aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat dhe ndryshimet gjatë dy viteve të fundit të jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 10: Ndryshimi i strukturës së aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat, 31.12.2023 krahasuar me 31.12.2022


Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'22	31.12.'23		31.12.'22- 31.12.'23	31.12.'22
Periudha	31.12.'22	31.12.'23	31.12.'22- 31.12.'23	31.12.'22	31.12.'23
Asetet neto të fondeve të pensionit	5,699.38	6,737.99	18.22		
Totali i aseteve të fondeve	5,716.76	6,755.08	18.16	100	100
<i>nga të cilët:</i>					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	109.17	131.91	20.83	1.91	1.95
Obligacione Thesari të R.SH.	5,494.05	6,481.18	17.97	96.10	95.95
Depozita bankare	-	-	-	-	-
Asete të tjera	113.54	141.99	25.06	1.99	2.10
Totali i Detyrimeve të Fondeve	17.38	17.09	-1.67	0.30	0.25

Në grafikun më poshtë është paraqitur ecuria e investimeve të tregut të fondeve të pensionit privat gjatë 5 viteve të fundit.



Grafik 23: Ecuria e investimeve të tregut të fondeve të pensionit privat


(Në mln.lekë)



Politika e investimeve për të gjitha fondet e pensionit privat, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në treg është afatgjatë, duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Politika e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 5, 7, 10 dhe 15 vjeçare, siç paraqitet në grafikun më poshtë, ku vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 10 vjeçar në masën 57.79%.


Grafik 24: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të fondeve të pensionit privat, 31.12.2023

(Në %)



Numri i anëtarëve në fondet e pensionit privat më 31.12.2023 ka arritur në 38,180, duke patur një rritje prej 4.55% në krahasim me 31.12.2022. Siç tregon edhe grafiku më poshtë, numri i anëtarëve të tregut të фондеве të pensionit privat gjatë 5 viteve të fundit ka ardhur duke u rritur.


Grafik 25: Ecuria e numrit të anëtarëve të tregut të фондеве të pensionit privat (Në numër)



Në 31.12.2023, në planet individuale të pensionit janë përfshirë 19,917 anëtarë, ose 52.17% e numrit të anëtarëve në treg dhe në planet profesionale të pensionit të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre janë përfshirë 18,019 anëtarë, të cilët përbëjnë 47.19% të numrit total të anëtarëve në treg. Ndërsa 244 anëtarë, ose 0.64% janë përfshirë njëkohësisht në planet individuale dhe ato profesionale.



Grafik 26: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit privat sipas planeve të pensionit,
31.12.2023 (Në %)



Mbikëqyrja me bazë rrezikun dhe analiza e rreziqeve të tregut

Tregu i fondeve të pensionit privat mbikëqyret sipas metodologjisë me bazë rreziku, e cila synon evidentimin në kohë të rreziqeve të mëdha që prekin këtë treg dhe zbatimin e strategjive të duhura për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Kjo metodologji, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për vlerësimin e rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit Privat, i cili mbledhet rregullisht dy herë në vit.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2023 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe është kryer vlerësimi i tyre, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë. Rreziku më i madh në kushtet e tregut vendas u identifikua pjesëmarrja e ulët e anëtarëve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me besueshmërinë në sistem. Komiteti i Rrezikut, me qëllim zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

Kapitulli 3 Aktiviteti Rregullues dhe Licencues

3.1 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit Privat


Viti 2023 shënoi zhvillime të rëndësishme sa i përket kuadrit rregullator. Kuvendi i Shqipërisë, më datë 21 shtator 2023, miratoi Ligjin nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”. Ky ligj përafrohet në masë të gjerë me Direktivën 2016/2341/KE, “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional” (IORP II).

Ligji “Për fondet e pensionit privat” u hartua nga Autoriteti me qëllim përmirësimin e bazës ligjore që rregullon tregun e fondeve të pensionit privat me kontribute të përcaktuara, për të krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e këtij tregu dhe nxitjen e kursimeve për pension. Ky ligj rregullon:

1. Licencimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë;
2. Krijimin dhe veprimtarinë e fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur, me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë;
3. Licencimin dhe veprimtarinë e depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat;
4. Mbikëqyrjen e shoqërisë administruese, fondeve të pensionit privat, depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat dhe të subjekteve të tjerë, sipas këtij ligji;
5. Veprimtarinë ndërkuftare të shoqërive administruese që ofrojnë fonde të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet zbatimit të këtij ligji janë:

1. Mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit privat, nëpërmjet vendosjes së standardeve më të larta për mirëinformim dhe transparencë, që nxisin besueshmërinë e investitorit në tregun e fondeve të pensionit privat;
2. Nxitja e pjesëmarrjes në skemë me anë të parashikimit të së drejtës së punëdhënësve/sindikatave/shoqatave të profesioneve të pavarura etj., për të krijuar fondin me pjesëmarrje të mbyllur të dedikuar posaçërisht për punëmarrësit e tyre;



3. Rritja e kursimeve për pension nëpërmjet rishikimit të politikës tatimore me synim krijimin e lehtësirave fiskale për anëtarët ekzistues apo të mundshëm, si dhe përfituesit e fondit;
4. Forcimi i kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator përmes kërkesave strikte për licencimin, mbikëqyrjen e shoqërive administruese të fondeve të pensionit, përfshirë rregullimin e aktivitetit ndërkufitar si dhe kërkesat lidhur me zbatueshmërinë e detyrimeve ligjore;
5. Rritja e profesionalizimit në administrimin e fondeve të pensionit privat nga ana e shoqërive administruese, përmes rritjes së kërkesave për qeverisjen e shoqërisë administruese dhe përshtatshmërinë e personelit kyç, krijimi i sistemit të administrimit të rrezikut, përfshirë analizën e vetëvlerësimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, si dhe në zbatim të kërkesave ligjore për plotësimin e kuadrit nënligjor, Autoriteti ka vijuar punën me hartimin e rregulloreve në zbatim të tij dhe deri në mars 2024 janë miratuar 4 rregullore, si më poshtë:

1. Rregullore nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e fondit të pensionit privat dhe licencimin dhe veprimtarinë e depozitarit të fondit të pensionit privat.
2. Rregullore nr. 2, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i elementëve të kontratës së anëtarësimit në fondin me pjesëmarrje të hapur për anëtarin individ dhe përcaktimi i elementëve të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, si për punëmarrësit e një punëdhënësi në fondin me pjesëmarrje të hapur, ashtu dhe për punëmarrësit e një sponsori në fondin me pjesëmarrje të mbyllur. Kjo rregullore përcakton elementët e kontratës së administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese, si dhe përmbajtjen dhe strukturën e prospektit të fondit të pensioni.


3. Rregullore nr. 3, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat”. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë administruese, si dhe i formës, llogaritjes dhe shumës së fondeve të veta që duhet të ketë në çdo kohë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat.
4. Rregullore nr. 4, datë 31.01.2024 “Për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat”. Kjo rregullore përcakton llojet e funksioneve, rregullave dhe procedurave për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat te palët e treta.

Rregulloret e hartuara publikohen për konsultim publik në faqen zyrtare të Autoritetit dhe kalojnë një proces të gjatë konsultimit me shoqëritë administruese të fondeve të pensionit.

3.2 Rregullimi i Tregjeve të Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

1. Rregullore nr. 4, datë 26.01.2023 “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit, që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe/ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së prospektit të plotë, elementët kryesorë të tij, si dhe miratimin dhe regjistrimin e prospektit për ofertën e titujve drejtuar publikut dhe/ose pranimin e titujve për tregtim në një treg të rregulluar, të regjistruar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë; forma dhe përmbajtja e suplementit që i shtohet prospektit; forma dhe përmbajtja e dokumentit të regjistrimit, shënimi mbi titullin dhe përmbledhja e prospektit, kur prospekti përbëhet nga këto dokumente si dhe procedura për miratimin e prospektit. Kjo rregullore përcakton, gjithashtu, kërkesat kur emetuesi me seli jashtë Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë tituj në Republikën e Shqipërisë.
2. Rregullore nr. 5, datë 26.01.2023 “Për kërkesat e transparencës në lidhje me Informacionin e shoqërive të listuara”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për dhënien e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm nga shoqëritë e listuara, titujt e të cilave janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë. Kjo rregullore përcakton mënyrën




dhe formën e dhënies së informacionit nga shoqëritë e listuara, për të siguruar transparencën e duhur, përmes informacionit të rregulluar, afatet për publikimin e informacionit, formën dhe përmbajtjen e raporteve vjetore të shoqërive të listuara. Kërkesat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme për të gjithë emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

3. Rregullore nr. 6, datë 26.01.2023 “Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit për shoqërinë komisionere, ku zbatohet parimi i proporcionalitetit, në lidhje me llojet e shërbimeve të investimit që ofron shoqëria komisionere dhe madhësinë e aktivitetit të saj.
4. Rregullore nr. 16, datë 28.02.2023 “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe ushtrimit të veprimtarisë operacionale të subjekteve që ofrojnë shërbime dhe veprimtari investimi, kërkesa të cilat synojnë në mbrojtjen e interesave të klientëve, në sigurimin e funksionimit të drejtë e të rregullt të tregjeve të kapitalit, dhe në rritjen e standardeve profesionale të këtyre subjekteve.
5. Rregullore nr. 71, datë 28.04.2023 “Për ndalimin e abuzimit me tregun”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave dhe procedurave të nevojshme për ndalimin e abuzimit me tregun, që lidhet me tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar, zbulimin e paligjshëm të informacionit të privilegjuar dhe manipulimin e tregut, me qëllim mbrojtjen e investitorit, sigurimin e integritetit të tregut dhe rritjen e besimit në treg.
6. Rregullore nr. 88, datë 31.05.2023 “Për licencimin dhe funksionimin e platformës shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), platformës së organizuar të tregtimit (POT) dhe kërkesat për shoqëritë komisionere që veprojnë si internalizues sistematik”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave dhe procedurave për dhënien e licencës për të operuar një platformë shumëpalëshe tregtimi (PSHT) apo një platformë të organizuar tregtimi (POT), mënyra e organizimit dhe funksionimit/ushtrimit të veprimtarisë të platformës shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), apo platformës së organizuar të tregtimit (POT), si edhe kriteret për trajtimin/pushimin e shoqërisë komisionere si internalizues sistematik.
7. Rregullore nr. 89, datë 31.05.2023 “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit

- të bursave dhe operatorëve të tregut, që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë të operatorit të tregut që vë në funksion një treg të rregulluar, si dhe përcaktimi i kërkesave për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Bursës.
8. Rregullore nr. 90, datë 31.05.2023 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Depozitarit Qendror të Titujve”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave dhe procedurës për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Depozitarit Qendror të Titujve.
 9. Rregullore nr. 91, datë 31.05.2023 “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të shtëpisë së klerimit dhe kundërpalës qendrore (CCP)”, objekti i së cilës ka për qëllim përcaktimin e kërkesave dhe procedurave të nevojshme për licencimin dhe funksionimin e shtëpive të klerimit dhe shtëpive të klerimit si kundërpalë qendrore (CCP), sipas përcaktimit të nenit 3, pika 14 dhe 10, të Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Gjithashtu ajo përcakton kërkesat për licencimin, organizimin dhe kryerjen e veprimtarisë të shtëpive të klerimit dhe shtëpive të klerimit që veprojnë si CCP.
 10. Rregullore nr. 92, datë 31.05.2023 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërisë komisionere dhe institucioneve të tregut”, objekti i së cilës është përcaktimi i kriterëve, kushteve dhe procedurave për miratimin e shoqërisë së auditimit të shoqërive komisionere dhe institucioneve të tregut nga Autoriteti.
 11. Rregullore nr. 197, datë 24.11.2023 “Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së raportimit periodik të shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucioneve të tregut”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i formës, përmbajtjes dhe afateve kohore të raportimit periodik të të dhënave, lidhur me veprimtarinë e shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucioneve të tregut, pranë Autoritetit, në funksion të marrjes së informacionit të standardizuar nga subjektet raportuese për efekt të mbikëqyrjes së tregut dhe statistikave.

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe në kuadër të shtimit të aktivitetit ndërkufitar të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, gjatë vitit 2023, Autoriteti hartoi dhe miratoi rregulloret si më poshtë:



1. Rregullore nr. 37, datë 31.03.2023 “Për njohjen e shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe njohjen e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës, rregullave dhe dokumentacionit për njohjen e shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së, me qëllim marketimin dhe shitjen e aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, në tituj të transferueshëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe njohjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së.
2. Rregullore nr. 38, datë 31.03.2023 “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për regjistrimin e personave juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e marketimit dhe shitjes së aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, në tituj të transferueshëm, të miratuara në një shtet anëtar të BE-së dhe të njohura nga Autoriteti.

3.3 Rregullimi i Tregut të Sigurimeve

Gjatë vitit 2023, në fushën e sigurimeve, ka filluar puna për hartimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Ligjin nr. 52, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Qëllimi i ndryshimeve dhe shtesave është rritja e nivelit të përfarimit të këtij ligji me Direktivën 2009/138/EC të Këshillit të Evropës, të datës 25 nëntor 2009, e njohur si Solvency II, si dhe pasqyrimi i rekomandimeve të raportit të vlerësimit të përputhshmërisë me ICP-të, kryer nga anëtarë të IAIS-it, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Anëtarit (Member Assessment Program). Në projektligj synohet të ketë kërkesa të shtuara, për një sistem efektiv të menaxhimit të rrezikut, mbikëqyrjes së grupit të sigurimit, qeverisje sa më të mirë të shoqërive të sigurimit dhe raporti i vetëvlerësimit të rrezikut.

Në kuadër të përmirësimit të metodologjisë mbikëqyrëse me bazë rreziku, gjatë vitit 2023, Autoriteti me asistencën teknike të Bankës Botërore, rishikoi në tërësi metodologjinë e vlerësimit të rrezikut për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, përfshirë edhe treguesit analitikë të paralajmërimit të hershëm. Metodologjia dhe treguesit e rishikuar janë reflektuar në Manualin “Për matricën e rrezikut dhe treguesit

analitikë për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 94, datë 31.05.2023 dhe në Udhëzimin “Për matricën e rrezikut dhe treguesit analitikë për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 95, datë 31.05.2023.

Nëpërmjet metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë rreziku, synohet të identifikohen në kohë rreziqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave mbikëqyrëse si: mbrojtja e interesave të konsumatorëve, promovimi i qëndrueshmërisë, rritja e transparencës dhe besueshmërisë në tregun e sigurimeve, si dhe garantimi i zbatimit të kuadrit ligjor e rregullator. Përmirësimet e kryera në këtë manual do të ndihmojnë më tej Autoritetin për një mbikëqyrje efektive dhe proaktive, me synim parandalimin e problemeve financiare të shoqërive të sigurimit.

Gjithashtu, numri i treguesve analitikë të paralajmërimit të hershëm, u rrit nga 16 në Manualin e mëparshëm të vitit 2014, në 44 tregues të dedikuar, sipas aktiviteteve kryesore të sigurimit. Këto indikatorë, përdoren gjerësisht në industrinë e sigurimeve dhe i shërbejnë Autoritetit për marrjen e informacionit në kohë dhe ndërhyrjen e duhur në drejtim të përmirësimit të shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit. Kufijtë referues (*benchmarks*) janë bazuar në praktikën ndërkombëtare, përfshirë vendet me tregje të ngjashme dhe vetë përvojën e Shqipërisë.

Zhvillime ka pasur edhe për sa i përket përgatitjes nga shoqëritë e sigurimit për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas Urdhrit nr. 106, datë 10.05.2023 të Ministrit të Financave. Në funksion të aplikimit të këtij standardi, Autoriteti me Vendimin e Bordit nr. 146, datë 31.08.2023 miratoi Udhëzimin “Mbi raportimin e shoqërive të sigurimit për zbatimin e SNRF 17 “Kontratat e sigurimit””, objekti i të cilit është marrja e masave nga shoqëritë e sigurimit për zbatimin e SNRF 17. Ky udhëzim përcakton hapa konkretë dhe afate për raportime të ndërmjetme të shoqërive të sigurimit, me qëllim përgatitjen graduale të tregut, deri në zbatimin e plotë të tij.

Të tjera

Në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe nisur nga detyrimet që rrjedhin nga legjislati në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Autoriteti hartoi dhe miratoi, Rregulloren nr. 3, datë 26.01.2023 “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Kjo rregullore përcakton procedurat organizative e teknike, masat për mbrojtjen dhe sigurinë, ruajtjen dhe administrimin, kriteret e përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale nga strukturat përgjegjëse për përpunimin e të dhënave personale në Autoritetin.



Me qëllim unifikimin e procedurave për shqyrtimin dhe trajtimin e të gjitha ankesave që depozitohen në Autoritet, u hartua dhe u miratua Rregullorja nr. 93, datë 31.05.2023 “Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave të depozituara në Autoritet nga konsumatori/investitori apo çdo person tjetër i interesuar në lidhje me veprimtaritë që kryhen nga subjekte të mbikëqyrura nga Autoriteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

3.4 Licencimi dhe Qeverisja

3.4.1 Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2023, Autoriteti ka miratuar njohjen e shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive “Eurizon Capital” S.A. dhe nënfondeve “Eurizon Fund - Azioni Strategia Flessibile” dhe “Eurizon Fund - Equity World Smart Volatility”, sipërmarrje investimi kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm (SIKTT), të miratuara nga CSSF në Luksemburg, për t'u marketuar dhe shitur në Republikën e Shqipërisë. Këto fonde kanë karakteristika ambientale dhe sociale (ESG), si dhe nxisin investimet në asete, të cilat ndjekin praktika të mira qeverisje. Kriteret ESG janë elementët bazë, mbi të cilat hartohet politika e investimeve të këtyre fondeve.

Gjithashtu, u regjistrua shoqëria “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së agentit të shitjes në Republikën e Shqipërisë të nënfondeve të njohura nga Autoriteti: “Eurizon Fund - Azioni Strategia Flessibile” dhe “Eurizon Fund - Equity World Smart Volatility”, miratuar nga CSSF në Luksemburg, nën administrimin e shoqërisë administruese “Eurizon Capital” S.A., të njohur nga Autoriteti.

Në vitin 2023, u licencua Fondi i Investimit “Sigal Invest” i administruar nga shoqëria “Sigal-Life Uniqa Group Austria” shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a.

Aktualisht, në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitet gjashtë shoqëri administruese, nga të cilat tri janë shoqëri administruese të fondeve të pensionit privat dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, dy janë shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe një është shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientë profesionistë dhe të kualifikuar.


Shoqëritë administruese të fondeve, administrojnë 13 SIK në formën ligjore të fondit të investimit, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, gjashtë fonde pensioni privat dhe 2 fonde të investimeve alternative, për klientë profesionistë dhe të kualifikuar.

Në tregun e fondeve, ushtrojnë aktivitetin e depozitarit të fondeve gjashtë banka, nga të cilat 3 janë të licencuara si depozitar i aseteve të fondeve të pensionit privat dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, dy janë depozitarë të aseteve të fondeve të pensionit privat dhe një bankë është depozitar i aseteve të fondeve të pensionit privat, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Të dhënat mbi shoqëritë administruese, sipërmarrjet e investimeve kolektive, fondet e pensionit privat dhe depozitarët, jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 11: Të dhëna mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e fondeve (Në numër)

Subjekte	2019	2020	2021	2022	2023
Shoqëri Administruese:	5	6	6	6	6
Shoqëri Administruese të SIK me ofertë publike	1	2	2	2	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit Privat	1	1	1	-	-
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK me ofertë publike	3	2	2	3	3
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK me Ofertë Publike dhe Fondeve të Investimit Alternativ për Klientë Profesionistë dhe të Kualifikuar	-	1	1	1	1
Sipërmarrje të Investimeve Kolektive (Fonde investimi)	6	9	11	12	13
Fonde Investimi Alternativ	-	-	2	2	2
Fonde Pensioni Privat	4	4	4	6	6
Depozitarë të fondeve:	6	6	6	6	6
Depozitar i Fondeve të Pensionit Privat	2	2	2	2	2
Depozitar i Fondeve të Pensionit Privat dhe Fondeve të Investimit	4	3	3	3	3
Depozitar i Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK me ofertë publike dhe Fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	1	1	1	1
Subjekte të njohura/regjistruara:					3
Shoqëri administruese e SIK					1
SIKTT					1
Agjentë shitje					1



Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe rregullatore, shoqëritë administruese janë të organizuara sipas sistemit të organizimit me një nivel qeverisje. Autoriteti miratoi tre emërime në funksione drejtuese, si administrator/anëtar të këshillit administrues dhe personel kyç të shoqërive administruese të fondeve, 13 riemërime në këto funksione, si dhe tre emërime si personel kyç i depozitarit.

Tabelë 12: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit privat

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri administruese	6	
Aksionarë gjithsej	17	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:</i>		100
nën 10%	7	41.18
mbi 10% nën 20%	2	11.76
mbi 20% nën 33 %	1	5.88
mbi 33% nën 50%	1	5.88
mbi 50%	6	35.29
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	7	41.17
Aksionarë vendas	10	58.83
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:</i>		100
Aksionarë individë	9	52.94
Aksionarë shoqëri	8	47.06

Në vitin 2023 nuk ka pasur miratime të ndryshimit të statutit të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit privat.

Tabelë 13: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore

(Në numër)

<i>Arsyeja e ndryshimit të Statutit</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>
Statut i ri/ndryshime të tjera	5	1	-	-	-
Rritje kapitali	1	1	-	1	-
Ndryshim i strukturës aksionare	2	-	-	1	-

Gjatë vitit 2023, janë miratuar dy delegime të funksionit të marketingut, për fondin e pensionit privat “Sigal Pro”, të administruar nga shoqëria “Sigal-Life Uniqa Group Austria” shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a. dhe fondin e pensionit privat “Smart Pension” nën administrimin e “Albsig Invest - shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., tek shoqëria “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a.

3.4.2 Tregjet e Kapitalit

Aktiviteti i Licencimit

Gjatë vitit 2023, si rezultat i bashkimit me përthithje të “Bankës Alpha Albania” sh.a. nga “Banka OTP Albania” sh.a., është hequr licenca e “Bankës Alpha Albania” sh.a. si shoqëri komisionere për ofrimin e shërbimeve të investimit për titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesën e shoqërisë “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a. është hequr licenca, si shoqëri brokerimi në tituj, për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe si shoqëri këshillimi për investime në tituj.

Gjithashtu, është hequr licenca e shoqërisë “Banka Alpha Albania” sh.a., si shoqëri komisionere për ofrimin e shërbimeve të investimit për Titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë: Marrje dhe transmetim i urdhrave; ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; tregtim për llogari të vet. Për instrumentet financiare si vijojnë: titujt e transferueshëm; instrumentet e tregut të parasë. Shoqëri për ofrimin e shërbimit ndihmës në Titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë: Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, si rezultat i bashkimit me përthithje të saj nga “Banka OTP Albania” sh.a.

Autoriteti miratoi riemërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., si dhe riemërimin e administratorit dhe tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a.

Në tregun e kapitaleve ushtrojnë veprimtari një Bursë titujsh, dy Regjistrarë, 11 shoqëri komisionere që ofrojnë shërbime investimi në tituj, nga të cilat nëntë janë banka, të cilat ofrojnë dhe shërbime ndihmëse të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve, dhe një bankë e cila ofron shërbime investimi *online*, nëpërmjet platformës “Smart Invest”.



Tabelë 14: Të dhëna historike mbi subjektet që veprojnë në tregun e kapitalit (Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>
Bursë titujsh	1	1	1	1	1
Shoqëri komisionere/Banka	14	12	13	13	11
<i>Nga këto:</i>					
<i>Banka që ofrojnë shërbim ndihmës për ruajtjen dhe administrimin e instrumenteve financiare</i>	9	9	9	10	9
<i>Banka që ofrojnë shërbim investimi online</i>				1	1
Regjistrar titujsh	2	2	2	2	2
Agjentë të lidhur të shoqërive komisionere të huaja	5	4	2	-	-

3.4.3 Tregu i sigurimeve

Aktiviteti i licencimit

Aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e sigurimeve u fokusua kryesisht në licencimin/miratimin/heqjen e licencës së ndërmjetësve në sigurime (agjentë/brokera), si dhe në licencim/rinovim licence të aktuarëve.

Shoqëri sigurimi

Aktualisht në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitet 12 shoqëri sigurimi, nga të cilat 8 në sigurimin e Jo-Jetës dhe 4 shoqëri në sigurimin e Jetës. Ky numër nuk ka ndryshuar që prej vitit 2019.

Ndërmjetës në sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të ushtrohet, si broker në sigurime, ose si agjent në sigurime. Brokerimi në sigurime mund të kryhet nga individët e licencuar si broker në sigurime, si broker fizik i pavarur nga shoqëritë e brokerimit dhe bankat e licencuara për të ushtruar këtë veprimtari nëpërmjet brokerit të licencuar.

Në vitin 2023 u licencua shoqëria “Banka OTP Albania” sh.a., për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime, për klasat e Jetës dhe Jo-Jetës.

Gjatë vitit 2023 i është hequr licenca shoqërisë “Banka Alpha Albania” sh.a., për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime, për klasat e Jetës dhe Jo-Jetës, si rezultat i bashkimit me përthithje të saj nga “Banka OTP Albania” sh.a.

Gjithashtu i është hequr licenca shoqërisë “SunTrust Broker” sh.a., për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime, për klasat e Jetës, Jo-Jetës dhe Risigurime, si dhe i është hequr licenca një individi, si broker në sigurime dhe një brokeri fizik të pavarur.

Gjithashtu, në vitin 2023, u licencua shoqëria “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër e për llogari edhe të shoqërisë së sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.

Në tregun e sigurimeve aktualisht janë të licencuara për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime 12 shoqëri brokerimi, pesë banka dhe tre brokera fizikë.

Nga 17 shoqëritë e brokerimit, gjashtë shoqëri brokerimi dhe një bankë ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, tre shoqëri brokerimi ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, tre shoqëri brokerimi dhe katër banka, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy klasat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tabelë 15: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit

(Në numër)

Viti	2019	2020	2021	2022	2023
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	9	8	8	7	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	6	7	7	7	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	4	4	4	4	3
Totali	19	19	19	18	17

Autoriteti miratoi 183 persona fizikë (agjentë) për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime, si dhe licencoi gjashtë subjekte juridike për të vepruar si agjentë në sigurime. Në tregun e sigurimeve janë të miratuar 973 individë për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe janë të licencuar 56 subjekte juridike, nga të cilat katër janë banka.

Tabelë 16: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime

(Në numër)

Agjent në sigurime	Të licencuar në fund të vitit 2022	Licenca të reja në 2023	Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2023	Të licencuar në fund të vitit 2023
Persona juridikë	57	6	7	56
<i>Nga këto, banka</i>	4			4
Person fizikë	882	183	92	973



Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Në tregun e sigurimeve janë të licencuar 51 individë si vlerësues dëmsh në sigurime, nga të cilët 27 individë e ushtrojnë këtë veprimtari si të punësuar pranë një shoqërie sigurimi dhe 24 si vlerësues të pavarur.

Në vitin 2023 nuk ka pasur licencime apo rinovime licencash për vlerësues dëmsh në sigurime.

Gjatë viti 2023 u licencua një aktuar dhe u rinovua licenca e tre aktuarëve.

Tabelë 17: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurime (Në numër)

Vlerësues sipas statusit/ llojit të licencës	Të licencuar në fund të vitit 2022	Rinovuar licenca në 2023	Licenca të reja në 2023	Përfunduar afati i licencës në 2023	Hequr licenca në 2023	Të licencuar në fund të vitit 2023
Sipas statusit të personit						
Të pavarur	28	-	-	4	-	24
Të punësuar	29	-	-	2	-	27
Sipas llojit të Licencës						
Dëme materiale	9	-	-	1	-	8
Dëme shëndetësore	16	-	-	3	-	13
Dëme materiale dhe shëndetësore	32	-	-	2	-	30
TOTALI	57	-	-	6	-	51

Qeverisja

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë e sigurimit me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori, apo bordi i drejtorëve, ushtron funksione administrimi. Nga 12 shoqëri sigurimi në fund të vitit 2023, 11 prej tyre janë të organizuara sipas sistemit me dy nivele dhe vetëm 1 shoqëri me një nivel.

Autoriteti miratoi dy emërimet në funksione drejtuese si anëtar të këshillit mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit, si dhe 29 riemërimet në funksionet administrator, anëtar këshilli administrues /mbikëqyrës.

Për sa i përket shoqërive të brokerimit, Autoriteti miratoi tetë emërime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive të brokerimit, si dhe 21 riemërime në këto funksione.

Shoqëritë e sigurimit janë kryesisht me kapital vendas, konkretisht nga 12 shoqëri sigurimi, nëntë janë me kapital vendas dhe tri me kapital kryesisht të huaj. Gjithashtu, nga 12 shoqëri sigurimi, 11 prej tyre kanë aksionar influencues, që zotëron mbi 50% të aksioneve.


Tabelë 18: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri sigurimi	12	
Aksionarë gjithsej	37	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100
nën 10%	18	50
mbi 10% nën 20%	4	13.16
mbi 20% nën 33 %	3	5.26
mbi 33% nën 50%	1	2.63
mbi 50%	11	28.95
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	2	5.26
Aksionarë vendas	35	94.74
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>		100
Aksionarë individë	28	76.32
Aksionarë shoqëri	9	23.68

Për vitin 2023 nga Autoriteti ka pasur tre miratime në lidhje me ndryshimet statutore të shoqërive të sigurimit, si dhe dy miratime në lidhje me ndryshimet statutore të shoqërive të brokerimit në sigurime.

3.5 Masat mbikëqyrëse dhe administrative

Kuadri rregullator, i cili rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit dhe Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, parashikojnë masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave dhe veprimeve, që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.



Në përputhje me kompetencat e tij, gjatë vitit 2023, Bordi i Autoritetit ka marrë 28 vendime si masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, kryesisht si rezultat i konstatimeve të dala nga analizimi i treguesve financiarë, nga inspektimet e kryera në vend nga Autoriteti, por edhe pezullime ose revokime licencash për ushtrimin e aktivitetit.

Në tregun e sigurimeve janë marrë 20 vendime dhe sipas llojit janë:

- 13 vendime për masa korigjuese dhe sanksione me gjobë ndaj shoqërive të sigurimit/person përgjegjës;
- 2 vendime për refuzim rishikimi ndaj kërkesave për rishikim;
- 2 vendime me masa korigjuese ndaj shoqërive të brokerimit në sigurime;
- 3 vendime me heqje licence ndaj subjekteve për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime.

Në tregun e titujve janë marrë 3 vendime dhe sipas llojit janë:

- Një shoqërie i është hequr licenca dhe është çregjistruar për të ushtruar veprimtarinë në tregun e titujve;
- Ndaj 2 bankave që ofrojnë shërbime investimi janë marrë masa korigjuese.

Në tregun e fondeve të pensionit privat dhe SIK janë marrë 2 vendime, të cilat janë vendime me masa korigjuese ndaj shoqërive administruese të fondeve të pensionit privat dhe SIK.

Ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, janë marrë 2 vendime me masa administrative.

Ndaj një banke është marrë një vendim, ku si rezultat i përthithjes së saj, i është hequr licenca si shoqëri komisionere për ofrimin e shërbimeve të investimit, si dhe licenca për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime.

Kapitulli 4 Bashkëpunimi Ndërinstitucional

4.1 Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Masat e marra nga Autoriteti në adresim të rekomandimeve të lëna nga komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, si dhe zbatimi i Planit të veprimit të ICRG/FATF

Autoriteti është pjesë e grupit ndërinstitucional, ngritur me Vendimin nr.1, datë 19.2.2020 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) dhe Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (ICRG). Autoriteti ka zbatuar Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Moneyval gjatë vitit 2023.


Gjithashtu, Autoriteti ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në kuadër të hartimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Shqipëri, i cili u miratua gjatë muajit dhjetor 2023, në takimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP).

Në vijim të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, Autoriteti së bashku me Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF), ka qenë përfitues i asistencës teknike të ofruar në kuadër të projektit “Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”, lidhur me vlerësimin e kuadrit ligjor shqiptar në përputhje me Rekomandimin 15 të Raportit të vlerësimit të Komitetit Moneyval të KE-së, me titull “Teknologjitë e reja”. Në përfundim të kësaj asistence, u lanë rekomandime për përmirësimin e praktikave mbikëqyrëse në kuadër të përputhshmërisë së legjislacionit në fuqi me kërkesat e FATF. Autoriteti ka kryer vlerësimin e rekomandimeve, si dhe ka ndërmarrë masat e nevojshme për adresimin e tyre. Autoriteti ka përgatitur dhe publikuar një material informues për publikun, në zbatim të rekomandimit për publikimin në faqen e institucionit, të informacionit për llojet e licencave dhe aktiviteteve që mbulon Ligji 66/2020, të përgjegjësive të subjekteve, përfshirë edhe çështjet e parandalimit të pastrimit të parave.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2023 në kuadër të PPP/FT

Gjatë vitit 2023 janë kryer në total katër inspektime, si më poshtë:

- Pranë brokerave në sigurime Jete janë kryer dy inspektime me objekt verifikimin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe zbatimin i masave të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;



Në përfundim të inspektimeve u lanë rekomandime për dy shoqëritë, të cilat ushtrojnë aktivitetin e brokerit në sigurimin e Jetës.

Gjatë vitit 2023, është bërë kategorizimi i rrezikut për subjektet e ligjit për PPP/FT, nën mbikëqyrjen e Autoritetit, bazuar në formularët e vetëvlerësimit. Për subjektet banka që ushtrojnë veprimtarinë e kujdestarisë është shkëmbyer informacion me Bankën e Shqipërisë. Rezultati i analizës për kategorizimin e rrezikut, dalë nga matrica e vlerësimit të kriterit për 11 subjektet, ka rezultuar “Nivel i ulët i rrezikut”.

Trajnime për PPP/FT

Lidhur me forcimin e kapaciteteve të Autoritetit, për PPP/FT, gjatë vitit 2023 stafi i Autoritetit ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Qendra e Studimeve për Krimin Ekonomik dhe Sigurinë (RUSI) dhe nga Këshilli i Evropës, ku janë trajtuar tema lidhur me rrezikun e teknologjive të reja dhe abuzimet me mjetet virtuale.

Gjatë vitit 2023 Autoriteti ka organizuar një trajnim, për ndërmjetësit në sigurime, në të cilin u përfshin dhe çështjet e PPP/FT.

4.2 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar

Bashkëpunimi i Autoritetit me organizatat, shoqatat, institucionet financiare, partnerët dhe donatorët është shtrirë më tej edhe gjatë vitit 2023. Autoriteti ka zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet homologe evropiane nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e mbikëqyrës. Synimi kryesor i bashkëpunimeve dhe projekteve lidhet me rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe konsolidimit të saj në tregjet financiare jobankare, si edhe mirërregullimit të tregjeve.

4.2.1 Memorandume Mirëkuptimi, 2023

Memorandum Mirëkuptimi me Komisionin Mbikëqyrës të Sektorit Financiar të Luksemburgut (CSSF)

Në shkurt 2023, Autoriteti nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Komisionin Mbikëqyrës të Sektorit Financiar të Luksemburgut (CSSF). Kuadri i përgjithshëm i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është hartuar mbështetur në objektivat dhe parimet për rregullimin e tregjeve nën mbikëqyrje, të përcaktuara nga Organizata

Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) dhe nga Autoriteti Evropian i Tregut të Letrave me Vlerë (ESMA).

Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet dy autoriteteve rregullatore siguron shkëmbimin e informacionit dhe përvojës në lidhje me përgjegjësitë rregullatore dhe mbikëqyrëse në tregjet e kapitalit, përfshirë tregjet e fondeve të investimeve dhe të pensioneve private. Gjithashtu ky memorandum synon të nxisë edhe bashkëpunimin në nivel teknik, me qëllim ndarjen e njohurive dhe shkëmbimin e pikëpamjeve në mënyrë të veçantë për çështje lidhur me rregullimin dhe mbikëqyrjen e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare (FMA)

Në shtator 2023, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare finalizoi me Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare (FMA) nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për konsultim, bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni, në kuadër të mbikëqyrjes së Entiteteve AIFMD.

Marrëveshja e nënshkruar me FMA (krahas Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s), synon forcimin e bashkëpunimit bilateral midis dy autoriteteve rregullatore, jo vetëm në tregun e sigurimeve, por edhe në tregjet e kapitalit, në lidhje me fondet e investimeve. Kjo marrëveshje lejon kryerjen e aktivitetit të llojeve të reja të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) në tregjet shqiptare dhe gjithashtu lejon tregtimin dhe shitjen ndërkufitare të kuotave të tyre.

4.2.2 Bashkëpunime me Autoritete Homologe

Në mars 2023, përfaqësues të Autoritetit dhe Ministrisë e Financave, realizuan një vizitë në disa institucione në Turqi, në **Agjencinë e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit të Sigurimeve dhe Pensioneve Private, Qendrën e Informacionit dhe Monitorimit mbi Sigurimet**, si dhe **Institucionin Publik Turk për Sigurimin nga Katastrofat**.

Gjatë vizitës u realizuan takime me përfaqësues dhe ekspertë të institucioneve, me synimin për të shkëmbyer informacione dhe eksperiencat më të mira për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sigurimit nga katastrofat (*Nat Cat*). Objektivi kryesor i këtyre takimeve ishin shkëmbimi i njohurive teknike, diskutimi mbi kuptimin dhe funksionimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm nga katastrofat në Turqi, kryesisht pas ngjarjes të tërmetit të muajit shkurt 2023.



Autoriteti është pjesëmarrës aktiv në nismën rajonale “**Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE-ISI)**”. Si pjesë e kësaj iniciative, Autoriteti mori pjesë në takimin e 21-të, i cili u organizua nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ANO) me mbështetjen Sekretariatit CESEE ISI (Bankës Qendrore të Hungarisë dhe FMA-së). Takimi u zhvillua në Malin e Zi, në prill 2023. Pjesëmarrësit në sesionet e ndryshme të konferencës shkëmbyen eksperiencat e vendeve të rajonit në sektorin e sigurimeve, si dhe paraqitën sfidat aktuale, duke theksuar rolin e autoriteteve rregullatore në mbrojtje të interesave të policëmbajtësve, me fokus financat e qëndrueshme dhe faktorët ESG.

Autoriteti, edhe gjatë vitit 2023, ka vijuar bashkëpunimin me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN)**. Në janar 2023, Autoriteti mori pjesë në një kurs online 2-javor të organizuar nga Qendra e Ekselencës në Financë (CEF), në bashkëpunim me FMN & AZN. Ky program ofroi një mundësi unike për autoritetet mbikëqyrëse të rajonit CEET në zhvillimin e proceseve të nevojshme, drejt implementimit të Standardit të ri Ndërkombëtar të Raportimit Financiar, SNRF 17, si dhe në zgjerimin e njohurive rreth, SNRF 17 dhe SNRF 9.

4.2.3 Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare e Rregullatore

Banka Botërore dhe **Fondi Monetar Ndërkombëtar** kanë mbështetur në vijimësi Autoritetin si partnerë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky bashkëpunim i shërben forcimit institucional, përmes mbështetjes në organizimin e trajnimeve nga ekspertët ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit të Autoritetit, si edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar.

Autoriteti, në periudhën gusht-shtator 2023, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga **Joint Vienna Institute (JVI)** në bashkëpunim me FMN me temë “*Financial Markets and Instruments*”. Temat e trajtuara në këtë trajnim lidheshin me tregun e kapitaleve, instrumentet financiare, si edhe sfidat dhe vlerësimin e rreziqeve me të cilat përballet ky treg.

Gjatë vitit 2023 mbështetja e **Bankës Botërore** ka qenë nëpërmjet projekteve, që lidhen me asistencën në drejtim të hartimit të bazës ligjore dhe rregullative në tregun e sigurimeve dhe fondeve të pensioneve private.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

Autoriteti është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që prej vitit 2001. Kjo organizatë synon vendosjen e standardeve dhe

zbatimin e parimeve themelore në mbikëqyrjen e sigurimeve, duke zhvilluar tregjet dhe mbrojtur të siguruarit, si dhe duke kontribuar në stabilitetin financiar global.

Në korrik 2023 u publikua në faqen zyrtare të internetit, raporti i plotë i vlerësimit të përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të Autoritetit me ICP-të, realizuar nga IAIS. Nga vlerësimi i këtij raporti, rezultoi një nivel i lartë përputhshmërie me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie. Ky vlerësim përbën një përparim të ndjeshëm kundrejt rezultateve të vlerësimit të bërë në vitin 2014, realizuar nga Banka Botërore dhe FMN.

Gjithashtu, në vitin 2023, Autoriteti ka marrë pjesë në Mbledhjet e Komiteteve Teknike, në Seminarin Global, si edhe në konferencën vjetore globale të organizuara nga IAIS. Fokus i konferencës ishte zbatimi i udhërrëfyesit të IAIS-it dhe planet e ardhshme të punës së kësaj shoqate, ku u diskutua mbi sfidat e ardhshme dhe roli i mbikëqyrësve në adresimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen nga katastrofat natyrore (NatCat), rrezikun e ndryshimeve klimatike, për të mundësuar një vlerësim më të mirë të rreziqeve financiare që vjen nga i ashtuquajtur fenomeni *greenwashing*.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, Autoriteti mori pjesë edhe në seminare të ndryshme të organizuara nga IAIS. Në këtë kuadër, Autoriteti mori pjesë në seminarin 3-ditor “IAIS 2023 Bootcamp for Assessors”, ku u diskutuan tema që lidhen me vlerësimin e zbatimit të standardeve të ICP-ve dhe *ComFrame* të IAIS-it, të ilustruara edhe me prezantime të rasteve studimore.

Autoriteti ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), në formatin virtual *e-learning* për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e sigurimeve për vitin 2023.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO)

Autoriteti është anëtar me të drejta të plota i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s që prej vitit 2009, i cili vendos standardet për bashkëpunim ndërkombëtar mes shteteve nënshkruese. Autoriteti merr pjesë në mbledhjet vjetore të Komiteteve të IOSCO-s.

Drejtues të lartë të Autoritetit ishin të pranishëm në takimin e 48të vjetor, i cili përbëhet nga Mbledhjet e Komitetit Rajonal Evropian (ERC), Komiteti i Tregjeve në Rritje e Zhvillim (GEMC), Komiteti i Presidentëve, Grupi i Monitorimit të



Marrëveshjeve Shumëpalëshe të Mirëkuptimit (MMoU MG) dhe konferenca globale për tregjet e kapitalit, të organizuara nga IOSCO.

Gjatë konferencës globale u diskutuan çështje të ndryshme si: vizionet e reja të sektorit financiar, sfidat dhe mundësitë, financat e qëndrueshme, taksonomia, investimet ESG, roli i korporatave dhe investitorëve për sigurimin e tregjeve financiare eficiente, të qëndrueshme dhe të gjelbra, digjitalizimi: zhvillimi i aseteve digjitale, teknologjitë dhe inovacionet e reja për zhvillimin e produkteve dhe modeleve të reja të biznesit.

Gjithashtu, drejtues të lartë të Autoritetit morën pjesë në takime të Komitetit Rajonal Evropian (ERC) organizuar nga IOSCO, në bashkëpunim me Autoritetin e Tregjeve dhe Shërbimeve Financiare të Belgjikës. Në fokus të takimit ishin financat e qëndrueshme, tregjet e karbonit, Fintech dhe Suptech. Gjatë takimit u diskutuan praktikat më të mira mbikëqyrëse në adresimin e rreziqeve që lidhen me fenomenin *greenwashing*.

Edhe gjatë vitit 2023, Autoriteti ka marrë pjesë në seminare të ndryshme të organizuara nga IOSCO.

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)

Autoriteti është anëtar me të drejta të plota, si dhe pjesë aktive e strukturave të Organizatës Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), që nga viti 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare e krijuar në vitin 2004, me iniciativë të OECD-së dhe Rrjetit Ndërkombëtar të Rregullatorëve dhe Mbikëqyrësve të Pensioneve (INPRS), e cila përfaqëson interesat e rregullatorëve të pensioneve private.

Autoriteti merr pjesë rregullisht në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore, Mbledhjet e Komiteteve Teknike të IOPS-it, si edhe në Forumin Global për Pensionet Private, të cilat gjatë vitit 2023 u organizuan nga OECD/IOPS.

Edhe gjatë vitit 2023, Autoriteti ka marrë pjesë në aktivitete dhe seminare të IOPS-it dhe Grupit të Punës së Pensioneve Private (WPPP), për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, duke pasur si prioritet përmbushjen e udhëzimeve *ad-hoc*, për periudhën 2019-2024.


Autoriteti ka kontribuar edhe në plotësimin e pyetësorëve lidhur me veprimtaritë mbikëqyrëse për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes në zhvillimin dhe plotësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, në fushën e pensioneve, plotësimin e pyetësorëve mbi rreziqet e likuiditetit, Sup Tech, si edhe informacione të ndryshme statistikore.

Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)

Organizata Botërore e Tregtisë është krijuar në vitin 1994 dhe synon nxitjen dhe vënien në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve tregtare ndërkombëtare. OBT ka autoritetin të administrojë dhe mbikëqyrë marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe praktikat tregtare botërore, si dhe të shqyrtojë dhe rregullojë mosmarrëveshjet tregtare midis vendeve anëtare. Ajo është pasardhëse e Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT), e themeluar në prag të Luftës së Dytë Botërore. OBT-ja ka 164 anëtarë, që përfaqësojnë rreth 98% të tregtisë botërore.

Shqipëria është anëtarësuar në OBT në 8 shtator 2000. Ministria e Financave është institucioni përgjegjës në vend për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me OBT, përgatit dhe miraton qëndrimet e Shqipërisë në OBT dhe, gjithashtu, koordinon punën me institucionet e tjera në vend lidhur me përgatitjen e notifikimeve periodike të vendit tonë në OBT.

Autoriteti është një ndër institucionet e përfshira në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në OBT. Në nëntor të 2023, në Gjenevë, Autoriteti ishte pjesë e delegacionit shqiptar në takimin për rishikimin e politikave tregtare në kuadër të OBT-së, ku u vlerësua puna e bërë në kuadrin e përparimeve ligjore dhe lehtësimin e barrierave tregtare, për një ekonomi sa më të qëndrueshme dhe të zhvilluar të vendeve anëtare të OBT-së.



4.3 Projekte

Projekti “Qëndrueshmëria dhe Zhvillimi Financiar: Rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe aksesit në financa të gjelbra dhe novatore” – BB / SECO

Banka Botërore si një nga partnerët kryesorë, mbështet Autoritetin në projektin ndërsektorial “Qëndrueshmëria dhe Zhvillimi Financiar: Rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe aksesit në financa të gjelbra dhe novatore”. Ky projekt financohet nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO).

Fokusi i Autoritetit për këtë projekt është në fushat:

1. Forcimi i mëtjshëm i kapaciteteve të Autoritetit për të mbikëqyrur:
 - Sektorin e Sigurimeve – zbatimi i udhërrëfyesit drejt Solvency II dhe IFRS 17;
 - Fondet e pensioneve private – rishikimi i akteve nënligjore;
 - Tregjet e kapitalit - obligacionet e gjelbra.
2. Përmirësimi i sistemeve të brendshme të IT, platformave të raportimit për t'u përballur me tregjet në rritje dhe zhvillimet FinTech, si dhe sigurinë kibernetike;
3. Zhvillimi i financave të gjelbra – në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në tetor 2023, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Bankën Botërore organizoi Konferencën Ndërkombëtare “Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”. Kjo konferencë mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë të Qeverisë Shqiptare, institucionet financiare ndërkombëtare, autoritetet mbikëqyrëse financiare dhe pjesëmarrës të tregut vendas dhe ndërkombëtar. Në konferencë u diskutua për “Mundësitë dhe sfidat për zhvillimin e sektorit të sigurimeve në Evropën Juglindore”, “Roli i sigurimeve në menaxhimin e riskut të katastrofave” dhe “Sfidat për zhvillimin e sigurimeve në bujqësi”. Panelistët ndanë mendimet dhe eksperiencat e tyre në lidhje me tregun e sigurimeve, praktikën botërore dhe nevojën për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtjshëm të sektorit të sigurimeve në rajon dhe në Shqipëri.

Projekti: “Forcimi i cilësisë së auditimit dhe raportimit (SOARP) - Forcimi i përcaktimit të standardeve dhe rritja e kapaciteteve të rregullatorëve financiarë për raportimin financiar” – BB / SECO

Projekti i financuar nga SECO dhe administruar nga Banka Botërore, ka për qëllim të përmirësojë kapacitetet institucionale të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Fokusi i këtij projekti janë monitorimi i zbatimit të standardeve të kontabilitetit, vendosja e standardeve, zhvillimi dhe zbatimi i metodologjisë së monitorimit të pasqyrave financiare të bazuara në rrezik.

Gjithashtu, kjo asistencë teknike mbështet Autoritetin për rritjen e kapaciteteve në zbatim të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF), SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”, si dhe përballjen me sfidat e sektorit të sigurimeve.


Projekte të mbështetura nga Zyra e Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit të Shtetit (OTA)

Gjatë vitit 2023 Autoriteti ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues nga Zyra e Asistencës Teknike e Departamentit Amerikan të Shtetit (OTA), lidhur me mundësinë e hartimit të projekteve të përbashkëta mbështetëse nga kjo zyrë. Ekspertë nga Seksioni i Zhvillimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe tregut të Sigurimeve, si edhe nga seksioni i tregut të kapitaleve vizituan Tiranën dhe u takuan me drejtues të Autoritetit, si edhe palë të tjera të interesit. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar fushat e mundshme të asistencës së OTA-s. Konkretisht, është dakordësuar asistencë teknike në disa drejtime: si në fushën e sigurimeve, tregjeve të kapitalit, teknologjisë së informacionit dhe edukimit financiar. Projekti do të fillojë në vitin 2024.

Projekti: “Zhvillimi i tregut financiar dhe të kapitaleve” - BERZH

Gjatë vitit 2023, përfaqësues dhe ekspertë të tregjeve të kapitalit dhe sektorit financiar të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesuar nga përfaqësuesja e zyrës së BERZH në Shqipëri, kanë diskutuar mbi prioritetet dhe bashkëpunimin e mundshëm me Autoritetin. Fokusi është vendosur tek ofrimi i mbështetjes teknike të BERZH, në rritjen e pjesëmarrjes së emetuesve në tregjet e kapitalit, zgjerimit të gamës së produkteve financiare dhe diversifikimit të bazës së investitorit.

BERZH ka konfirmuar angazhimin e tij në vijim, me qëllim dhënien e asistencës kryesisht në përgatitjen e raporteve diagnostikuese për potencialin e tregjeve të kapitalit, mbështetje legjislative për zhvillimin e instrumenteve të reja financiare si “covered bonds” dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve. Projekti do të jetë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave.



Projekti: “Zhvillimi i një Kuadri Ligjor dhe Rregullator për Derivatvët dhe *Repos* në Shqipëri” – BERZH

Autoriteti është pjesë e grupit të punës, së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave në zbatimin e këtij projekti, i cili ka filluar në vitin 2023 dhe pritet të zgjasë 18 muaj. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti ndërsektorial është të zhvillojë një kuadër ligjor dhe rregullator për derivativët dhe *repos* në Shqipëri. për të garantuar zbatueshmërinë e transaksioneve me derivativë dhe *Repo* (përfshirë koncepte si neto mbyllëse dhe kolateral financiar).

Projekti “Lehtësimi i përgjegjësisë në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike ndaj palëve të treta (Green Card) sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike” - CEFTA

Shqipëria është anëtare *Central European Free Trade Agreement (CEFTA)* dhe Autoriteti është një ndër institucionet e përfshira në zbatimin e planit të veprimit dhe angazhimeve në kuadër të saj. Si pjesë e këtyre angazhimeve, gjatë vitit 2023, në kuadër të Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM)/ CEFTA u zbatua projekti “Lehtësimi i përgjegjësisë në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike ndaj palëve të treta (*Green Card*) sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike”. Si pjesë e projektit dhe nën koordinimin e Ministrisë së Financave, u hartua Udhërrëfyesi i cili identifikoi veprimet, masat kryesore, aktorët dhe afatin kohor për të mundur arritjen e një sistemi të ngjashëm me BE-në për përgjegjësinë në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike ndaj palëve të treta (*Green Card*) të vendeve anëtare në CEFTA. Autoriteti do të vazhdojë punën sipas Udhërrëfyesit dhe projektit i cili është parashikuar të zgjasë deri në fund të vitit 2024.

Misioni i asistencës teknike nga ekspertët e TAIEX, për zhvillimin e kuadrit ligjor në tregun e sigurimeve


Në kuadër të përafrimit ligjor dhe rregullator me *acquis* të BE-së dhe në zbatim të angazhimeve të PKIE-së, Autoriteti ka filluar punën për përgatitjen e ndryshimeve ligjore në fushën e sigurimeve. Gjatë muajit nëntor 2023, Autoriteti u asistua nga një mision i TAIEX-it (*Technical Assistance and Information Exchange*), me ekspertë nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë (HANFA). Gjatë këtij misioni u trajtuan çështje kryesore që lidhen me zbatimin e direktivës së regjimit mbikëqyrës Solvency II, implementimi i së cilës kërkon qasje të kujdesshme dhe shtrirje në kohë, për të garantuar qëndrueshmëri në tregun e sigurimeve. Ekspertët ndanë përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera, që e kanë kaluar më herët procesin e përafrimit të legjislationit me këtë direktivë.

Rekomandimet e lëna nga ekspertët e TAIEX-it në raportin e tyre përfundimtar, do të mbahen në konsideratë gjatë përgatitjes së ndryshimeve në ligjin e sigurimeve, parashikuar gjatë vitit 2024, sikurse përfshirë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024.

4.4 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit

Dokumenti politik “Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, u miratua nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 266, datë 26.04.2023. Për hartimin dhe finalizimin e këtij dokumenti Autoriteti ka bashkëpunuar me **Ministrinë e Financave** si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për zhvillimin e tregut të kapitaleve. Dokumenti strategjik 5-vjeçar synon promovimin dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit, duke synuar njëkohësisht edhe mbështetjen dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Në këtë kuadër, Autoriteti, në maj 2023 organizoi një tryezë diskutimi “Mbi zhvillimin e tregjeve të kapitalit”, me pjesëmarrjen e Ministres së Financave dhe Ekonomisë, Zv. Guvernatores së parë të Bankës së Shqipërisë, drejtues të lartë të bankave tregtare, fondeve të investimeve, Bursës, si edhe aktorë të tjerë të tregjeve të kapitalit.

Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me **Bankën e Shqipërisë** edhe përgjatë vitit 2023, si në projekte të përbashkëta, ashtu edhe në vijim të bashkëpunimeve ekzistuese. Autoriteti është anëtar e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave. Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë për ndërtimin e iniciativave të përbashkëta për rritjen e edukimit dhe përfshirjes financiare. Autoriteti ka qenë pjesëmarrëse në takimet për Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, KKSP, i cili synon të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Gjithashtu, të dy institucionet janë pjesë e projekteve dhe takimeve të përbashkëta si për financat e gjelbra (GIZ) ashtu edhe për zhvillimin e tregut të derivativeve në Shqipëri (BERZH).



Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Konfidencialiteti me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)

Gjatë vitit 2023, Autoriteti në kuadër të bashkëpunimit me institucionet brenda vendit, me qëllim rritjen e sigurisë kibernetike, si edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027, ka bashkëpunuar me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), për të finalizuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Konfidencialitetit. Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi midis dy institucioneve, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe partneritetit dypalësh, lidhur me rritjen e sigurisë kibernetike dhe minimizimin e rreziqeve që lidhen me të. Kjo marrëveshje synon vendosjen e urave të bashkëpunimit lidhur me sigurinë kibernetike, raportimin e të gjitha llojeve të incidenteve të sigurisë kibernetike në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për sigurinë kibernetike, ndarjen e informacionit në lidhje me përhapjen e programeve keqdashëse, shkëmbimin e materialeve edukative dhe trajnuese lidhur me sigurinë kibernetike.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të rregullimit të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit 2023, ka vijuar komunikimin me **Autoritetin e Konkurrencës**.

Autoriteti dhe **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)** kanë vijuar edhe gjatë vitit 2023 bashkëpunimin, përmes inspektimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të informacionit për tregjet dhe subjektet nën mbikëqyrje.

Kapitulli 5

Mbrojtja Konsumatore dhe Transparenca me Publikun

5.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit

Gjatë vitit 2023, Autoriteti ka vijuar punën e tij në përmbushje të objektivave të Strategjisë së institucionit 2023 -2027, për mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe investitorit, si:

- Shqyrtimi i ankesave, lidhur me trajtimin e problematikave të tyre nga subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti;
- Monitorimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari në tregjet nën mbikëqyrje, lidhur me transparencën e tyre në shërbimin e ofruar konsumatorit/investitorit, duke respektuar të drejtat dhe interesat e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet që lidhen me investimet në instrumente financiare, për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të mbikëqyrura dhe përdoruesve të shërbimeve të tyre;
- Edukimi i vazhdueshëm i përdoruesve të shërbimeve financiare, duke përfshirë dhënien e informacionit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit, si dhe të dhënat mbi performancën e subjekteve të mbikëqyrura.

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve

Trajtimi i ankesave të konsumatorëve është një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të Autoritetit. Gjatë vitit 2023, Autoriteti me Vendim Bordi nr. 93, datë 31.05.2023, ka miratuar rregullore e re të ankesave “Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Kjo rregullore konsolidon procedurat për shqyrtimin e ankesave jo vetëm për tregun e sigurimeve, por edhe për tregjet e kapitalit, të fondeve të pensioneve private dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorit/investitorit synon zgjidhjen në mënyrë profesionale, të paanshme dhe të shpejtë të ankesave të depozituara, me qëllim ndërhyrjen në kohë, për të shmangur përsëritjen e problematikave të njëjta në të ardhmen.

Gjatë vitit 2023, në Autoritet janë depozituar 160 ankesa, kundrejt 173 ankesave të trajtuara në vitin 2022, duke pësuar një rënie prej 8% të numrit të ankesave nga viti paraardhës. Pas ndërhyrjes së Autoritetit, janë zgjidhur rreth 46% e këtyre ankesave.

Nga ankesat e trajtuara, rreth 88% e tyre janë paraqitur në rrugë elektronike, në adresën konsumatori@amf.gov.al, ose amf@amf.gov.al, si edhe nëpërmjet Regjistrin *Online* të ankesave në faqen zyrtare online të Autoritetit.


Tregu i sigurimeve dominon me 95% të numrit të ankesave, tregu i pensioneve/investimeve me 1% të ankesave, ndërsa 4% janë ankesa jashtë kompetencave të Autoritetit.



Në ankesat e tregut të sigurimeve, sigurimi TPL është segmenti me numrin më të madh të ankesave, me 84% të numrit të ankesave. Pas sigurimit TPL, numrin më të madh të ankesave e zë Sigurimi Kufitar/Kartoni Jeshil, me 6% të numrit të ankesave dhe ndiqet më pas nga ankesat në lidhje me sigurimin e jetës dhe shëndetit me 3% të numrit të ankesave.

Grafik 27: Ankesat sipas llojit të sigurimit


(Në numër)



Në ankesat e depozituara për produktet në tregun e sigurimeve mbizotërojnë ato me objekt dëmin material, në masën 75% të totalit të ankesave, ndjekur nga ankesat me objekt dëmin shëndetësor në masën 19% të totalit të ankesave.

Grafik 28: Ankesat sipas llojit të dëmit

(Në numër)




Shkaqet kryesore të ankesave gjatë vitit 2023 ishin:

- Vonesë në pagesën e dëmshpërblimit;
- Pretendime për vlerën e dëmshpërblimit;
- Vonesë në trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim;
- Refuzimi i kërkesës për dëmshpërblim;
- Shkaqe të tjera.

Grafik 29: Ankesat sipas arsyes së ankimit

(Në numër)



Ankesat me objekt vonesën e pagesës së dëmshpërblimit dominojnë me 32% të numrit total të ankesave, e ndjekur nga pas nga ankesat me objekt pretendimi për vlerën e dëmshpërblimit me 28% të numrit total të ankesave.

5.2 Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë

Gjatë vitit 2023, Autoriteti ka monitoruar në vijimësi nëpërmjet raportimeve periodike, apo verifikimeve në vend, zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore të aktivitetit të ndërmjetësimit në tregjet nën mbikëqyrje.

Në kuadër të monitorimit në distancë (*off-site*), Autoriteti ka kryer analizën e pasqyrave financiare të ndërmjetësve në sigurime, bazuar në raportimet e tyre me frekuencë 6-mujore, me qëllim monitorimin në vazhdimësi të treguesve kryesorë të aktivitetit, sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatore në fuqi. Kështu, janë monitoruar tregues si: kapitali, fondi i garancisë, mjetet monetare, rezultati financiar i aktivitetit, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Këto rezultate i janë vënë në dispozicion edhe Bordit të Autoritetit.



Gjithashtu janë kryer dhe inspektime në vend pranë:

- Një shoqërie brokerimi në sigurime;
- Dy bankave tregtare, që kryejnë edhe funksionin e agjentit në sigurime;
- Dy bankave tregtare, që kryejnë edhe funksionin e brokerit në sigurime.

Inspektimet kishin në fokus kushtet teknike dhe organizative të këtyre shoqërive, kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë, si dhe respektimin e kërkesave ligjore e rregullatore në fuqi, për kryerjen e aktivitetit të ndërmjetësimit dhe mbrojtjen e konsumatorit. Pas mangësive të konstatuara nga inspektimi në vend, Bordi i Autoritetit mori masat përkatëse ndaj subjekteve.

5.3 Edukimi Financiar dhe Marrëdhëniet me Publikun

Autoriteti vlerëson edukimin financiar, si një nga përparësitë e punës së tij, në funksion të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe përfshirjes financiare. Bordi i Autoritetit në gusht 2023, miratoi “Strategjinë për Edukim dhe Përfshirje Financiare 2023-2027”. Kjo Strategji përcakton objektivat e Autoritetit për periudhën 5-vjeçare dhe ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë efektive për lehtësimin e qasjes së publikut në produktet financiare.

Ndër objektivat specifike të kësaj Strategjie, që synojnë konsumatorin dhe investitorin janë:

- Të thellojë njohuritë për tregun e sigurimeve, të kapitalit dhe produktet e pensioneve, si dhe rreziqet e lidhura me to;
- Të rrisë besimin tek institucionet financiare, të cilat rregullohen dhe mbikëqyren nga Autoriteti;
- Të marrë vendime financiare të shëndosha dhe të bazuara në informacion të plotë, të saktë dhe të qartë; dhe
- Të përfshihet në produktet që ofrojnë tregjet e kapitalit, të sigurimeve dhe të pensionit privat.

Fokusi i zbatimit të kësaj Strategjie janë përmirësimi i sistemit të ankesave për konsumatorët dhe investitorët, pasurimi i faqes zyrtare me informacione të dedikuara për publikun, etj. Transparenca dhe komunikimi me publikun mbeten në vëmendje të Autoritetit, duke synuar kanalet e reja të komunikimit, mediat tradicionale dhe sociale, dhe format e tjera të komunikimit jo mediatik në grupe më të vogla të synuara.

Veprimtaria e Autoritetit, në zbatim të strategjisë fokusohet në grupet e synuara, si Korporatat dhe institucionet e qeverisjes vendore; Punonjësit në sektorin publik dhe privat; Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme; Studentët në shkolla dhe universitete; dhe Profesionistët në tregjet nën mbikëqyrje.

Në kuadër të kësaj Strategjie, gjatë vitit 2023, Autoriteti zhvilloi disa aktivitete, në bashkëpunim me shoqatat e profesionistëve që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje. Autoriteti organizoi në 20 nëntor 2023, një tryezë diskutimi me shoqëritë e sigurimeve, mbi rëndësinë e procesit të zbatimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar, SNRF17 në tregun e sigurimeve, si një sfidë e të ardhmes.

Gjithashtu, vijoi puna për organizimin e trajnimeve të profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje, për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim, të tillë si broker dhe vlerësues dëmsh në sigurime, me synim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjes më të mirë të interesave të konsumatorit/investitorit. Gjatë trajnimeve të kryera i është kushtuar vëmendje e veçantë paraqitjes së risive të kuadrit rregullator, akteve të reja nënligjore të përafuara me direktivat evropiane, si dhe përditësimit të njohurive me zhvillimet e reja globale.

Autoriteti bashkëpunon me aktorë të ndryshëm, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të zhvilluar dhe zbatuar iniciativa për edukimin financiar. Autoriteti, në bashkëpunim me *German Sparkassenstiftung Albania*, organizuan aktivitetin “Të mësojmë për bursën” – *Stock Market Learning Competition 2023*, i cili ka në fokus nxitjen e edukimit financiar të studentëve për tregjet e kapitalit. Ky është viti i tretë që Autoriteti bashkëpunon për zhvillimin e këtij aktiviteti me studentët e fakulteteve ekonomike të universiteteve publike dhe jo publike të vendit.

Konferenca ndërkombëtare “Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore”-18 tetor 2023, Tiranë

Kjo konferencë u zhvillua në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Sekretariatit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Bankën Botërore. Në të morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të Qeverisë Shqiptare, institucioneve financiare ndërkombëtare, autoriteteve mbikëqyrëse financiare dhe pjesëmarrës të tregut vendas dhe ndërkombëtar. Konferenca ishte e organizuar në tre panele gjatë të cilave u shkëmbyen eksperiencat për tregun e sigurimeve, praktikat botërore dhe nevojën për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve në Shqipëri dhe në rajon.

Në panelin e parë të konferencës, Ministri i Financave, ekspertë të Bankës Botërore dhe përfaqësues të lartë të IAIS-it diskutuan mbi rolin e sigurimeve në menaxhimin e riskut të katastrofave, modelet dhe praktikat më të mira botërore të aplikuara për skemat e sigurimit nga katastrofat, si edhe implementimin e tyre në Shqipëri dhe në vendet e rajonit.

Në panelin e dytë dhe të tretë përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare dhe autoritetet rregullatore evropiane dhe të rajonit ndanë përvojat e tyre lidhur me



mundësitë dhe sfidat për zhvillimin në përgjithësi të sektorit të sigurimeve në Evropën Juglindore, si dhe ofruan këndvështrimet e tyre për modelet e aplikuara për sigurimet në bujqësi, mundësitë dhe sfidat për zhvillimin e këtij produkti në vend.

Marrëdhëniet me Publikun

Gjatë vitit 2023 faqja *online* e Autoritetit është konsultuar për të gjetur informacione lidhur me kuadrin ligjor e rregullator, subjektet e licencuara, informacionet statistikore për ecurinë e tregjeve, ashtu edhe për komunikimin e drejtpërdrejtë për ankesat e konsumatorëve. Statistikat mujore tregojnë një mesatare prej mbi 30,000 shikues që konsultojnë faqen *online* për informacione të ndryshme. Faqja tërheq gjithnjë vizitorë të rinj, dhe mbi 30% e klikimeve në faqe janë nga vizitorët e rinj, të cilët shikojnë më shumë se 3 nënseksione të saj.

Faqja *online* e Autoritetit është lehtësisht e aksesueshme në formatet e ndryshme teknologjike, dhe shifrat e klikimeve tregojnë se rreth 66% e përdoruesve të faqes e kanë aksesuar atë nga *desktop*, ndërsa pjesa tjetër e kanë vëzhguar faqen online nga aparatet e telefonisë celulare.

Për t'i shërbyer edhe investitorëve apo analistëve të huaj, faqja *online* e Autoritetit është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të dyja formatet e faqes japin informacion për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private, fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit.

Botimet e Autoritetit të realizuara në vitin 2023

- Buletini Zyrtar
- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve

Publikime elektronike të Autoritetit

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private
- Buletini Statistikor i tregut të fondeve të investimeve

Kapitulli 6 Institutional Organization


6.1 Burime Njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe administrimi efektiv i tyre konsiderohet i rëndësishëm në realizimin e objektivave dhe përgjegjësi të institucionit. Edhe gjatë vitit 2023, Autoriteti ka qenë e orientuar drejt rritjes profesionale të punonjësve, qëndrueshmërisë së kapaciteteve administrative, si dhe optimizimit të strukturës organizative të institucionit.

Plotësimi i strukturës organizative, si dhe ofrimi i mundësisë së promovimit në linjë me objektivat strategjikë të tij, gjatë vitit 2023 është realizuar përmes procedurave të konkurimit të hapur dhe transparent. Kështu katër punonjës të Autoritetit kanë konkuruar dhe kanë fituar pozicione më të larta në hierarkinë e pozicioneve të punës dhe katër punonjës të rinj me njohuri profesionale dhe përvojë cilësore u bënë pjesë e stafit të Autoritetit.

Grafik 30: Ndarjet funksionale sipas departamenteve

(Në %)




Gjithashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar edhe ruajtjes së raportit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Përfaqësimi gjinor në Autoritet, raporti burra-gra në nivel drejtues është 25% kundrejt 75%, si dhe mosha mesatare e stafit është 41 vjeç.



Grafik 31: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës

(Në numër)



Kualifikimi profesional

Duke vlerësuar rëndësinë e aftësive profesionale të punonjësve në realizimin me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme ka nxitur dhe ka mundur kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve profesionale të punonjësve. Gjatë vitit 2023, stafi i Autoritetit ka qenë pjesëmarrës në trajnime, seminare dhe aktivitete të tjera, të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e njohurive dhe rritjen e ekspertizës profesionale. Gjatë vitit 2023, rreth 57% e stafit teknik ka ndjekur aktivitete trajnuese. Aktivitetet kanë konsistuar në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira profesionale me autoritetet homologe, institucionet financiare, si dhe me shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve ku Autoriteti është anëtar. Rëndësi i është kushtuar edhe aktiviteteve trajnuese të realizuara në vend, në bashkëpunim me projektet e ndryshme me institucione të huaja duke i shërbyer forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Përgjegjshmëria sociale

Autoriteti synon të forcojë më tej vlerat shoqërore, të rrisë ndërgjegjësimin e punonjësve të tij, nëpërmjet aktiviteteve vullnetare, në ndihmë të komuniteteve në nevojë.

Në kuadër të ndjeshmërisë dhe reagimit qytetar, Autoriteti në muajin tetor 2023 mbështeti nismën “Dhuro gjak, shpëto një jetë”. Ky akt solidariteti u realizua në koordinim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.


Gjithashtu në prag të festave të fundvitit, punonjësit e Autoritetit kanë kontribuar në baza vullnetare, për të ofruar ndihmë dhe përkujdesje ndaj fëmijëve të “Shtëpisë së Foshnjës”, Tiranë.

6.2 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2023, Autoriteti ka kryer zhvillime në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese duke rritur mekanizmat kontrollues, me fokus rritjen e sigurisë kibernetike. Këto zhvillime kanë marrë në konsideratë edhe sfidat në nivel kombëtar dhe global mbi sigurinë e sistemeve të informacionit.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2023 përmblihen si më poshtë:

- Finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Autoriteti dhe Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK). Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve lidhur me sigurinë kibernetike, shfrytëzimin sa më të mirë të informacionit mbi rreziqet e sigurisë së informacionit, infrastrukturën funksionale dhe të monitoruar, raportimin e të gjitha llojeve të incidenteve të sigurisë kibernetike në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për sigurinë kibernetike, ndarjen e informacionit në lidhje me përhapjen e programeve keqdashëse, shkëmbimin e materialeve edukative dhe trajnuese lidhur me sigurinë kibernetike;
- Në zbatim të detyrave të lëna nga Komiteti i Sigurisë Kibernetike, Autoriteti ka ndërmarrë një sërë masash në kuadër të mbrojtjes së të dhënave dhe ruajtjes nga sulmet kibernetike, si: Blokimin e trafikut në disa shtete të njohura si burim dhe/ose në përdorim të grupeve keqdashëse kibernetike; Mbrojtjen nga email-et me përmbajtje dyshuese; Blokimin e qarkullimit të skedarëve zip; Kontrollin e vazhdueshëm të akseseve; etj. Autoriteti ka ndjekur me prioritet zbatimin e politikave të sigurisë së informacionit sipas rekomandimeve të institucioneve publike përgjegjëse për sigurinë e informacionit në vend, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të tij;



- Rritja e sigurisë kibernetike duke implementuar antivirus të qendëruar në Cloud server i cili përfshin mbrojtjen nga Malware, Ransomware, System and Application Patch, IP blacklists, Hash blacklists, Firewall USB storage controls për çdo përdorues në institucion;
- Analizimin e sistemeve digjitale në ofrimin sa më të thjeshtë të informacionit ndaj palëve të treta, si dhe monitorimin apo përmirësimin e raportimit të ankesave *online*.

Autoriteti ka sisteme të raportimit online ku janë të përfshira edhe subjektet që vepron në tregjet nën mbikëqyrje. Kështu është vepruar me:

- Përditësimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit AMF In-Reg, si platformë e raportimit *online*, ku shoqëritë e sigurimit raportojnë të dhënat financiare të kërkuara nga Autoriteti. Versioni i përditësuar mundëson një shkallë më të lartë sigurie, përditësim me teknologjinë e kohës, si dhe ofrimin e funksioneve të reja;
- Realizimin e trajnimit *online* të dhjetë specialistëve të Autoritetit, faza e parë e të cilit përfundoi në fund të vitit 2023. Trajnimi rrit aftësitë e punonjësve të Autoritetit për të lexuar dhe interpretuar raportet që gjenerohen, dhe njëkohësisht i mundëson të ndërtojnë raporte të reja, të cilat i shërbejnë nevojës për informacion për të gjitha nivelet drejtuese;
- Zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të raportimit financiar për tregun e fondeve të investimeve dhe pensioneve, në kuadër të ofrimit të integritetit më të thjeshtë të shoqërive.


Digjitalizimi i shërbimeve në portalin e-Albania

Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve, gjatë vitit 2023, Autoriteti ka reduktuar ndjeshëm kërkesat shkresore për shërbimet të cilat ofrohen në mënyrë elektronike.

Shërbimet *online* nga portali www.e-albania.al edhe gjatë vitit 2023 funksionuan për qytetarët për të marrë informacionet si:

- Verifikoni Policën Tuaj;
- Verifikoni Historikun e Dëmeve të Mjetit;
- Verifikoni Statusin e Dosjes së Dëmit.

Grafik 32: Shërbimet e ofruara nga portali E-Albania sipas kërkesave gjatë vitit 2023 (Në %)



Shërbimet e ofruara nga portali www.amf.gov.al

Përlllogaritësi i dëmeve

Përlllogaritësi i dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit, u zhvillua nga Autoriteti për t'i ardhur në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmeve dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Përlllogaritësi bazohet në disa supozime dhe vlerat e përlllogaritura janë orientuese. Ato synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit, me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.

Verifikoni Historikun e Dëmeve të Mjetit

Shërbimi elektronik "Historiku i dëmeve" u mundëson qytetarëve marrjen e informacionit mbi rastet e përfshirjes në aksidente rrugore si shkaktar. Të dhënat për dosjet e dëmeve gjenerohen nga Regjistri Elektronik Online i Dëmeve, sipas raportimit nga shoqëritë e sigurimeve, në përputhje me aktet nënligjore.

Verifikoni Statusin e Dosjes së Dëmit

Çdo person i dëmtuar, në proces dëmshpërblimi mund të kontrollojë *online* statusin e dosjes së tij të dëmshpërblimit për të ndjekur fazën në të cilën ndodhet dosja. Ky kontroll mundësohet nga vendosja e Kodit të Dëmit.




Depozito ankesën *online*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit ka ofruar mundësinë e depozitimit *online* të ankesave dhe trajtimin e ankesave të personave të siguruar dhe investitorëve. Zbatimi i CRM ka kanalizuar kryesisht ankesat online nëpërmjet kësaj platforme dhe duke i ofruar përgjigjen *online* nëpërmjet faqes zyrtare të Autoritetit.

Grafik 33: Shërbimet e ofruara nga portali i AMF, viti 2023

(Në %)



6.3 Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm e ka orientuar aktivitetin në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar me Vendim Bordi nr. 248, datë 20.12.2022. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, si dhe një auditues të teknologjisë së informacionit. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Auditimi u përqendrua kryesisht në fushat e vlerësuara me nivel të lartë rreziku nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Cilësia e auditimit konsiderohet jo vetëm faktor i rëndësishëm në prezantimin e auditimit (raportit) dhe rezultateve të tij: opinionit, konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve; por edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së audituesve gjatë auditimit dhe njësive të audituara për zbatimin e rekomandimeve.

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2023 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontroleve të brendshme për funksionet dhe proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve. Tregues kryesor i ndikimit të punës audituese është ndryshimi pozitiv që auditimi i brendshëm sjell nëpërmjet rekomandimeve mbështetur në një përjasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve.



STRATEGJI DHE OBJEKTIVA

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit gjatë vitit 2024, në zbatim të objektivave të Strategjisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027, do të përqendrohen në:

- Forcimin e stabilitetit financiar, rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve;
- Përafrimin e legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimin dhe modernizimin e tregjeve;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe investitorit;
- Zhvillimin e financimit të gjelbër dhe harmonizimin me praktikatat evropiane;
- Digjitalizimin dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

1. Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e stabilitetit financiar, zhvillimit dhe shëndetshmërisë të tregjeve financiare jo bankare nën mbikëqyrje, nëpërmjet forcimit të mëtejshëm të funksionit të tij mbikëqyrës, monitorimit të treguesve kryesorë financiarë dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Autoriteti, me qëllim avancimin drejt procesit të përafrimit të akteve ligjore dhe nënligjore me acquis të BE-së, do të finalizojë ndryshimet e parashikuara në Ligjin e sigurimeve 52/2014, i cili do të sjellë përmirësime në kuadrin rregullator të qeverisjes korporative; mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve, etj, duke adresuar edhe rekomandimet e dhëna nga ekspertët e IAIS-it në raportin e tyre të vlerësimit të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me Parimet Themelore në Sigurime (ICP). Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me ekspertët e Bankës Botërore për zbatimin e udhërrëfyesit të mbikëqyrjes në sigurime, Solvency II, si angazhim në kuadër të përafrimit të legjislacionit me direktivat e BE-së dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes.

Prioritet dhe sfidë afatshkurtër e Autoritetit, është zbatimi i plotë dhe në kohë i Standardit të ri Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e sigurimit”, me qëllim përgatitjen graduale të tregut të sigurimeve drejt zbatimit të këtij standardi.

Do të synohet implementimi i strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në drejtim të nxitjes dhe zhvillimit të këtij tregu, si një alternativë e qëndrueshme financimi, përkundrajt burimeve tradicionale të financimit.

2. Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve

Autoriteti është institucioni drejtues i Kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, në negociatat e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Gjatë vitit në vijim, Autoriteti me qëllim përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore me acquis të BE-së, do vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, i cili hyri në fuqi në 6.11.2023. Për një pjesë të këtyre akteve rregullatore Autoriteti do të mbështetet edhe përmes asistencës teknike të Bankës Botërore.


Në kuadër të angazhimeve në takimin bilateral në Bruksel, Autoriteti ka ngritur grupin e përbashkët të punës me ekspertë të Autoritetit dhe BSH dhe do të vijojë puna për hartimin e udhërrëfyesit për transpozimin e direktivës evropiane, mbi mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe firmave të investimeve, në një konglomerat financiar.

Në procesin e negociatave, Autoriteti do të vijojë të japë kontributin e tij, si pjesë e grupeve ndër-institucionale për kapitujt e tjerë, pjesë e kriterit ekonomik. Avancimi legjislativ drejt standardeve evropiane mbështet zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, përmes krijimit të mundësive të reja, duke i modernizuar më tej këto tregje.

3. Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit

Mbrojtja dhe informimi i konsumatorit dhe investitorit, do të vijojnë të jenë në fokus të veprimtarisë së Autoritetit edhe gjatë 2024, si një nga objektivat themelore të strategjisë për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027.

Ligjet e miratuara vitet e fundit, si për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit private janë shoqëruar me akte nënligjore të Autoritetit, të cilat synojnë rritjen e kërkesave për transparencë dhe informacion, sipas standardeve ndërkombëtare. Autoriteti do të vijojë me plotësimin e kësaj baze ligjore edhe në ardhmen. Në këtë kuadër, Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me



shoqatat e profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje, për të realizuar planin e tij të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere.

Në tregun e sigurimeve, nëpërmjet një projekti me asistencë teknike të huaj, do të vlerësohet niveli i informimit të konsumatorëve dhe sjelljes së tregut, problematikat ku duhet ndërhyrë për të rritur përfshirjen financiare, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit/investitorit. Autoriteti do të krijojë një ekip trajnerësh që do të zhvillojnë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe edukimin e konsumatorëve. Gjithashtu, Autoriteti do të vijojë përmirësimin dhe digjitalizimin e sistemit të ankesave për konsumatorët dhe investitorët. Kanalet e reja të komunikimit, mediat tradicionale dhe rrjetet sociale, format e tjera të komunikimit jo mediatik, në grupe më të vogla të synuara, do të vijojnë të përdoren për të rritur transparencën dhe komunikimin publik.

4. Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane

Në kuadër të zbatimit të dokumentit të politikave “Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, miratuar nga Këshilli i Ministrave në prill 2023, Autoriteti vijon bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në drejtim të nxitjes dhe zhvillimit të tregut të kapitaleve. Projektet e përbashkëta ndërinstitucionale, mbështetur me asistencë teknike, do të vlerësojnë mundësinë e zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vend, si alternativë e qëndrueshme zhvillimi si për kompanitë me kapital shtetëror edhe njësitë e qeverisjes vendore.

Autoriteti synon promovimin e financave të gjelbra, dhe përfshirjen e faktorëve mjedisorë, social dhe të qeverisjes korporative (ESG) në bazën ligjore, nëpërmjet nismave ndërgjegjësuere për faktorët e gjelbër. Sfidë e punës së Autoritetit është integrimi i faktorëve ESG për investime të qëndrueshme, rritja e ndërgjegjësimit të investitorit shqiptar për të orientuar vendimmarrjen e tij drejt produkteve financiare të gjelbra.

5. Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit


Autoriteti do të vazhdojë të punojë për implementimin e teknologjive të reja, me qëllim përmirësimin e proceseve mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe rritjen e sigurisë kibernetike duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse në vend.

Pas përmirësimit dhe zhvillimit të sistemeve të raportimit që lidhen me tregun e sigurimeve do të punohet në drejtim të pasurimit me forma të reja raportimi të cilat do ndihmojnë drejtimin në vendimmarrje dhe do të mundësojnë një pasqyrim më transparent të treguesve tekniko-financiar të industrisë.

Në kuadër të politikave të sigurisë, menaxhimit të rrezikut kibernetik dhe mbarëvajtjes së sistemeve që administrohen nga Autoriteti, do të punohet ngushtësisht me institucionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të përmbushen standardet e sigurisë sipas legjislacionit në fuqi si dhe zbatimin e rekomandimeve për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe besueshmërinë e informacioneve që Autoriteti disponon. Rritja e sigurisë kibernetike kryesisht do të fokusohet në implementimin e procedurave/iregulloreve sipas standardit ISO/IEC 27001, me qëllim shmangien e rreziqeve dhe rritjen e sigurisë kibernetike si një prioritet për Autoritetin. Lidhur me këtë prioritet, Autoriteti do të mbështetet nga Zyra e Asistencës Teknike (OTA) e Departamentit Amerikan të Thesarit, për vlerësimin e rrezikut, sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike për të gjitha sistemet në përdorim nga Autoriteti me qëllim implementimin e standarteve më të mira ndërkombëtare.

Zhvillimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit do të shërbejnë për digjitalizimin e proceseve të raportimit, standardizimin dhe automatizimin e proceseve mbikëqyrëse, qasje në kohë reale në sistemet e subjekteve të mbikëqyrura, analizimin dhe menaxhimin e të dhënave të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë efikase, si dhe për të ruajtur integritetin e tregut.

SHTOJCA A
STRUKTURA ORGANIZATIVE E AMF-SË, 2023



SHTOJCA B RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR



Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” (Institucioni), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Institucionit më 31 dhjetor 2023, performancën e saj financiare dhe rrjedhën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Institucioni në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.


Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Institucionit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) janë audituar nga auditues tjetër, i cili me datë 20 mars 2023 ka shprehur një opinion të pa modifikuar mbi këto pasqyra financiare.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi



i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Institucionit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Institucionin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit.

Të dhëna të tjera

Drejtimi është përgjegjës për të dhëna të tjera. Të dhënat e tjera konsistojnë në të dhëna të përfshira në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi, në përputhje me Nenin 17 dhe 19 të Ligjit nr. 25/2018 “Të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare”, i ndryshuar, por nuk përfshin Pasqyrat Financiare dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti vjetor pritet të jetë i disponueshëm për ne, pas datës së këtij Raporti të Audituesit të Pavarur. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon të dhëna të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë opinionimi mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat e tjera të identifikuar më lart, kur këto të dhëna të jenë të disponueshme dhe, duke e bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare apo njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose në të kundërt nëse është material. Gjatë rishikimit të raportit vjetor, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, nga ne kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale

kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Institucionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Institucionit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Institucioni të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.



Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë më, 28 mars 2024

Kreston Albania Sh.p.k.

Rruga Muhamet Gjollesha, shk. B, K. 6, Ap. B-6
Pranë Qendrës Tregtare Ring Tirane Shqipëri, 1001
Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm L42007012I



Nuriona Bërdica
Auditues Ligjor
Partner Angazhimi

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lekë)

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	66,158,298	75,205,401
Aktivet afatgjata jomateriale	14,627,712	19,503,615
Totali i aktiveve afatgjata	80,786,010	94,709,016
Aktivet afatshkurtra		
Llogari të arkëtueshme	69,107,917	49,793,634
Paradhënie dhe të ardhura të përlogaritura	2,454,202	1,878,955
Garanci të dhëna	463,580	463,580
Investime ne depozita dhe Bono Thesari	160,393,600	145,616,212
Mjetet monetare në arkë e në bankë	58,855,842	103,511,329
Totali i aktiveve afatshkurtra	291,275,141	301,263,710
Totali i aktiveve	372,061,151	395,972,726
KAPITALI		
Fonde bazë	119,287,505	119,287,505
Rezerva	184,758,000	180,287,000
Totali i kapitaleve të veta	304,045,505	299,574,505
DETYRIMET		
Grante për asete		
Totali i detyrimeve afatgjata	7,041,061	7,416,571
Totali i detyrimeve afatgjata	7,041,061	7,416,571
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme	1,273,874	9,883,562
Detyrime për tatim taksa	8,853,470	7,933,913
Detyrime nga shoqërive të mbikëqyrura	29,271,203	49,014,026
Të tjera të pagueshme	342,736	916,847
Fondi i provizionit	21,233,302	21,233,302
Totali i detyrimeve afatshkurtra	60,974,585	88,981,650
Totali i detyrimeve	68,015,646	96,398,221
Totali i kapitalit dhe kapitalit	372,061,151	395,972,726

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lekë)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga tregu i sigurimeve	346,556,475	318,993,374
Të ardhura nga tregjet kapitale	3,139,020	3,603,897
Të ardhura nga tregu i sipërmarrësve të investimeve kolektive	27,468,954	41,020,752
Të ardhura nga tregu i pensioneve vullnetare	3,820,175	3,214,426
Totali i të ardhurave	380,984,624	366,832,449
Zbritje për të ardhurat të trajtuara paradhenje e subjekteve të mbikeqyrura për periudhën pasardhese	(29,271,203)	(49,014,026)
Totali i të ardhurave përfshire paradhenjet	351,713,421	317,818,423
Të ardhura të tjera	9,775,510	16,400,000
Shpenzime personeli	(274,676,777)	(254,945,219)
Shpenzime administrative	(54,636,202)	(48,971,980)
Shpenzime amortizimi	(15,036,607)	(16,611,118)
Total shpenzime	(344,349,586)	(320,528,317)
Të ardhura nga interesat e depozitave	4,130,869	1,596,724
Fitim/humbje nga kembimet valutore	(16,799,214)	(9,327,830)
Rezultati i vitit	4,471,000	5,959,000

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

